



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Imazheri”

Ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë

“Universiteti European i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Niko Hyka

2. Dr. Gjok Tosku

Tetor /2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bsc në “Imazheri” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë
Universiteti European i Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Imazherisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Imazheri”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 557 datë 12.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 PAE/ 2PAK v.a. 2018-2019 16 PAE/ 5PAK v.a. 2019-2020 17 PAE/ 4PAK v.a. 2020-2021
18	Numri i studentëve:	9 Studentë v.a. 2018-2019 43 Studentë v.a. 2019-2020 31 Studentë v.a. 2020-2021
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti European i Tiranës është një institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr.636, datë 20.09.2006 dhe është riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 46, datë 05.07.2019, me kohëzgjatjen e parashikuar në Vendimin nr.12., datë 07.04.2017 me afat të përcaktuar deri në 06.04.2022. Aktualisht institucioni është në proces riakreditimi institucional. Në vitin akademik 2018-2019 është licensuar Programi i ciklit të parë të studimeve, Bachelor në “Imazheri” i cili ofrohet nga Departamenti i Imazherisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Programi është licencuar me Urdhër Nr. 557, datë. 12.09.20181, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë të asaj periudhe (sot Ministria e Arsimit dhe Sportit). Programi ka filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018 – 2019 dhe aktualisht diplomon brezin e parë të studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin European të Tiranës, përgjegjës për programin e studimit, është përbërë nga 3 njësi bazë: Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti i Imazherisë, Qendra e Kërkimeve Shkencore në Shëndet Publik Programi i studimit BSc. Imazheri, është organizuar në përputhje me Udhëzimin e e MAS, VKM 41 të ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore të UET. Ai ofrohet në gjuhën shqipe, me kohë të plotë në 3 vite dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e ciklit të parë “Bachelor” në “Imazheri”. Programi i studimit është vlerësuar me 180 kredite. Sipas deklarimeve të institucionit, ky program është bazuar në disa shembuj konkretë nga institucione ndërkombëtare me qëllim kryesor përgatitja dhe formimi i specialistëve imazherist me njohuritë themelore teorike dhe praktike si dhe përvojën në fushën e imazherisë për të shërbyer në qendra të ndryshme diagnostike në pozicionin e Teknikut të imazherisë/radiologut. Në programin e studimit aktualisht studiojnë 120 studentë dhe janë angazhuar rreth 21 personel akademik dhe ndihmës akademik dhe janë në zbatim disa marrëveshje bashkëpunimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të parë të programit të studimit Bachelor në “Imazheri”, i ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës. Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të parë bachelor, pjesë e Kodit të Cilësisë. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, mbështesin vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e vlerësimit [ascal.al] të miratuar nga ASCAL/BA dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga ASCAL sipas të cilave procesi i vlerësimit zgjat 103 ditë [agjenda e fazes se vlerësimit].

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks [lista e evidencave].

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Dr. Niko Hyka, Dr. Gjok Tosku dhe Koordinatori Teknik nga ASCAL për këtë proces vlerësimi z. Muhamed Prezja.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj fazë janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në UET e zhvilluar në datën 21.03.2022. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.[agjenda e vizitës]
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.



Në përgjithësi dokumentacioni i yënë në dispozicion është i plotë dhe mbulon fushat e vlerësimit. GVJ konstaton se Raporti i vlerësimit të brendshëm nuk është shkruar qartë pasi në

përmbushje të disa standarteve/kritereve, informacioni i dhënë është i përgjithshëm, i paplotë dhe jo i referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e të saktë.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UET. Pas dërgimit të drafraportit në institucion, GVJ ka reflektuar në versionin përfundimtar të raportit disa prej komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nga ana e institucionit. Konkretisht janë reflektuar pikat: 1, 2, 9 të relacionit të dërguar me shkresë Nr.prot. 120.11, datë 20.09.2022.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të vlerësimit të brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion. GVJ merr në konsideratë edhe vështirësitë që ka patur institucioni gjatë pandemisë Covid 19 ku impakti është i dukshëm në veprimtari të ndryshme mësimore, praktika profesionale etj.

Gjithashtu, GVJ falenderon ASCAL dhe Koordinatorin Teknik për mënyrën e menaxhimit dhe korrektësinë e treguar gjatë gjithë procesit.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Imazheri

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti European i Tiranës është një institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr.636, datë 20.09.2006 dhe është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 93, datë 20.10.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike. UET ushtron veprimtarinë dhe aktivitetin e tij në përputhje me ligjin 80/15 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe në përputhje me të ka rishikuar të gjitha aktet normative të tij. [Vkm hapje, Vendim akreditimi] Programi ofrohet në përputhje të plotë me interes kombëtar të vendit, Statutin e saj si dhe rregulloren e programit të studimit, duke patur si synin përgatitjen e profesionistëve në shkencat e shëndetit në tërësi dhe diagnostikës në veçanti e duke kontribuar në këtë mënyrë në konsolidimin dhe ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. [7]
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i ciklit të parë të studimeve, Bachelor në “Imazheri” i cili ofrohet nga Departamenti i Imazherisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Programi është licencuar me Urdhër Nr. 557, datë. 12.09.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit duke u njohur në këtë mënyrë si program që në themel të tij ka ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. [urdhër hapje 557] Programi synon edukim të studentëve, duke ruajtur dhe konsoliduar vlerat akademike e kulturore kombëtare në të njëjtën linjë me interesat kombëtare. [7]
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bsc. Imazheri, është hartuar në përputhje dhe në zbatim të misionit dhe qëllimit të institucionit [38] Sic tregohet dhe në statutin e UET, ky program studimi, është në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë të institucionit dhe njësisë kryesore. [4]. Misioni dhe qëllimi i programit të studimit është përgatitja e specialistëve të aftë të fushës së imazherisë dhe diagnostikës etj. [38] Pajisja e këtyre specialistëve me teknikat, instrumentet dhe metodat më bashkëkohore (sasiore dhe cilësore), përmes të cilave ofrohen zgjidhje për probleme të ndryshme me të cilat ata do të përballen gjatë ushtrimit të profesioni të tyre. Pajisja e radiologëve me njohuritë më të avancuara teorike e praktike, duke bërë të mundur në këtë mënyrë, absorbimin e tyre nga tregu i punës brenda dhe jashtë vendit sikundër citohet edhe në dosjen e programit të studimit..
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen	Programi është i fushës së mjekësisë, fushë e cila pas këtyre viteve të pandemisë Covid 19, ka marrë një interes të shtuar përsa i përket

<p>në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>rëndësisë në shëndetin e popullatës. Programi vjen në të njëjtën linjë me kërkesat e shtuara të institucioneve shëndetësore për profesionistë në qendrat diagnostike të vendit. [17]</p> <p>Edhe në studimin e tregut të bërë nga ana e institucionit në argumentimin e hapjes [17], i është kushtuar rëndësi kontributit që mund të sjellë programi në përmirësimin të nivelit të diagnostikës shqiptare dhe në punësimin e të rinjve në mjekësi. Programi synon t'u mundësojë këtyre specialistëve njohuritë e duhura dhe kualifikim të mëtijshëm në programet e ciklit të dytë që këta studentë mund të vazhdojnë në të ardhmen [7]</p> <p>Programi i studimit Bsc. në Imazheri është hartuar në përputhje me nevojat që ka vendi dhe tregu i punës duke përgatitur specialistë të radiologjie, të cilët për shkak se janë të kërkuar nga tregu i punës, largohen jashtë vendit. e në këtë mënyrë programi ndihmon në zbutjen e kërkesës që ka sistemi shëndetësor në vend</p> <p>Sipas deklarimeve të drejtuesve, programet e studimit të ofruara nga UET bazohen në studime të kryera nga institucioni lidhur me nevojat që ka rajoni dhe vendi. Nga analiza e dokumentacionit, GVJ, evidentoi raste konkrete studimi që kanë orientuar hapjen dhe zhvillimin e programeve në tërësi apo këtë program studimi në veçanti.</p> <p>Referuar edhe planit strategjik të të zhvillimit të programit [4], informacionet janë të limituara përse i përket prioriteteve dhe sikundër ka evidentuar edhe vetë institucioni, do të përditësojë atë pas 5 vitesh duke reflektuar nevojat e reja që ka tregu vendas dhe ai ndërkombëtar për teknikë radiologjie dhe mundësitë e reja që janë hapur për zhvillimin e programit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Vlerësimi</p> <p>Universiteti European i Tiranës ushtron veprimtarinë dhe aktivitetin e vet në përputhje me ligjin 80/15 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me statutin dhe aktet rregullative të saj.[1], [29]. GVJ konstaton se Programi i studimit Bsc në Imazheri është në përputhje me strategjinë institucionale dhe objektivat e institucionit për zhvillimin makro të tij. [strategjia UET 15-20]. Programi i studimit i pajis studentët me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe njohuri profesionale në nivelin bachelor të nevojshme për të garantuar ushtrimin e profesionit pas përfundimit të studimeve.</p>

<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Universiteti ka hartuar dhe miratuar Statutin e UET [2] me Vendim Senati Akademik me vendim nr.8 datë 3.11.2016 dhe me Urdhër nr. 90, datë 28.02.2017, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Rregulloren e Përgjithshme të institucionit [5] si dhe në përputhje me to të gjitha aktet e tjera normative të Institucionit. Programi i studimit Bsc në Imazheri, funksion në përputhje të plotë me statutin dhe rregulloren e UET. Aktualisht UET ka disa drejtime kryesore duke përfshirë edhe atë të mjekësisë. Programi është pjesë e fushave kryesore të operimit të institucionit . [të dhëna AMS]</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit është licensuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Nr. 557 datë 12.09.2018, ka filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019, është organizuar dhe strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit, dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe organizuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.[2], [3], [5].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Imazheri, ka të përcaktuara në përmbajtjen e tij, [4] se objektivat e formimit për studentët, janë përgatitja e tyre për tregun e punës me njohuri teorike e profesionale të teknikut të imazherisë</p> <p>Referuar objektivave të përcaktuara si koncepte themelore në syllabyset e lëndëve, kostatohet që ky program studimi ka për qëllim formimin e specialistëve me njohuri në fushën e teknikave imazherike.</p> <p>Imazheristët e diplomuar në këtë program studimi, të jenë të aftë profesionalisht të ofrojnë shërbim me nivel të lartë në fushën e mjekësisë.</p> <p>Përmbajtja e programit mundëson formimin e një figure profesionale të aftë për t'i vënë aftësitë e veta në shërbim të shëndetit të njerëzve. [14, 14.2]</p> <p>Në këtë program, synohet që studentët të marrin përgatitje teorike dhe praktike veçanërisht krijimin dhe formimin e avancuar profesional duke u fokusuar në aplikime të reja të teknikave të avancuara në shkencat imazherike në përputhje me nivelin e këtij cikli studimi. [16].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron,</p>	<p>GVJ konstatoi që institucioni kryen studime për tregun e punës. Në takimin me përfaqësuesit e departamentit, GVJ u njoh me aktivitetin konkret për ndjekjen e tregut të punës [59]. Edhe personeli akademik konfirmoi se janë kryer disa analiza bazuar në</p>

<p>përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>njohjet që ata kanë në fushën e tyre. Ndërkohë çdo vit organizohet “UET open weeks” pjesë e të cilit është edhe Panairi i punës, me Qëndrat Shëndetësore, klinikat private, firmat farmaceutike, spitalet dhe OJF, paraqesin mundësitë e tyre për të punësuar.[51], Institucioni ka bashkëpunime me institucione shëndetësore në vend, ku merren statistika të diplomuarve, emigrimit të tyre. Megjithatë GVJ konstaton se studimi i tregut të punës është jo plotë dhe gjithëpërfshirës. Edhe pse Drejtuesi i departamentit është përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve me Bordin e Tregut të Punës për të konsultuar përputhshmërinë e përmbajtjes së programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, apo për të analizuar ecurinë e zhvillimit të praktikave ende nuk ka rekorde të mjaftueshme pasi ky program studimi diplomon për herë të parë e për rrjedhojë, treguesit e matshëm janë të limituar. Institucioni duhet të marrë në konsideratë analizën e plotë të tregut të punës pas diplomimit të studentëve duke ndjekur në kohë punësimin e tyre dhe duke marrë feedback në kuadër të përmirësimit të programit.[12.1], [12.2]</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit në “Imazheri” ka qëllim të pajisë studentët me: Njohuritë themelore të imazherisë dhe radioterapisë, etikës profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional; [4]</p> <ul style="list-style-type: none"> – Njohuri të avancuara në specialitete të veçanta të shërbimit imazherik si dhe të përgatitjes për mbrojtjen e shëndetit të pacienteve nga rrezatimet e ndryshme që përdoren në teknikat imazherike, – Aftësi në mënyrën e komunikimit midis kolegëve, eprorëve, vartësve, pacienteve dhe familjarëve. për përdorimin e mjeteve informatike dhe telematike në fushat me kompetenca specifike <p>Në tërësi, realizimin e këtyre objektivave GVJ e konstaton të arrirë bazuar në informacionet që siguroi duke analizuar kurikulën ekzistuese, syllabuset e lëndëve të veçanta në kategorizimin e tyre A, B, C, D dhe E, duke shqyrtuar planet strategjike të zhvillimit [4] si dhe duke parë angazhimin konkret si të personelit akademik e ndihmës ashtu edhe të studentëve. [14, 14.1, 14.2, 14.3</p> <p>Megjithatë, në përmbajtjen e programit, GVJ mendon se ka hapësira që disa lëndë/module të mund të riorganizohen ose përshtaten për një profilizim më të mirë të programit të studimit. Gjetjet dhe konstatimet e detajuara jepen në fushën 3 të vlerësimit të këtij raporti.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi I.4
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin mbështetës por edhe gjatë vizitës në institucion, konstaton që institucioni në tërësi ka infrastrukturën, kapacitetet për të ofruar programin e studimit Bachelor në "Imazheri". [42, 42.1]</p> <p>Burimet Infrastrukturore: Mjediset për studentët (Auditore, Klasa për leksione dhe seminare, Laborator për vizualizimin anatomic virtual, Laboratorë informatike, Bibliotekë, Mjedise për fotokopjim/librari, Zyra për informimin e studentëve, Mjedise sociale); Mjedise për stafin (Zyrat, Sallat e mbledhjeve, Mjedise për personelin e shërbimit, Mjedise shlodhëse). Shërbime IT etj [42.1]</p> <p>Burimet njerëzore: Personeli akademik pavarësisht se është relativisht i ri, ka njohuri të teknikave imazherike pasi shumica e tyre janë njëkohësisht personel në qendrat diagnostike në vend.</p> <p>Në total, në funksion të programit të studimit, në nivel fakulteti në vitin akademik 2020-2021, janë angazhuar 2 Prof.Dr. dhe 2 Prof. As. Dr. personel akademik efektiv; 7 lektorë me kualifikimin Dr. personel akademik efektiv dhe 1 lektor me kualifikimin Dr. personel akademik me kontratë; si dhe 9 asistentë lektorë (MSC.) të angazhuar me kohë të plotë dhe 7 asistentë lektorë (MSC.) të angazhuar me kohë të pjesshme [23]</p> <p>GVJ identifikon si praktikë të mirë angazhimin si personel akademik të treknikëve të imazherisë që kanë përfunduar të njëjtin program studimi dhe që janë në ushtrimin e profesionit. Megjithatë në disa module, është e nevojshme përfshirja e lektorëve si titullarë lëndësh me tituj e grada shkencore. Në mirëkuptojmë vështirësitë që has institucioni në gjetjen e personelit të kualifikuar në këtë fushë studimi ku për më shumë se 10 vite ka numër të ulët të profesionistëve që kanë marrë tituj dhe grada shkencore por njëkohësisht inkurajojmë që përpjekjet për të rekrutuar personel të ri që kanë kualifikimet e nevojshme të rekrutohen në vijimësi.[02].</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Imazheri, rreferuar rregulloreve të UET dhe departamentit, [6] është në përputhje të plotë me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë. Ky program ofrohet me 180 ECTS për 3 vite akademike, në përfundim të tij studentët pajisen me diplomën Bachelor në Imazheri, niveli 6 në Kornizën e kualifikimit të diplomave. (KSHK) dhe direktivat evropiane për profesionet e rregulluara.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të fakultetit. [1], [3.3]</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe</p>	<p>GVJ referuar rregullores së departamentit, konfirmion se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. [6]</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Imazheri, ofrohet në bashkëpunim edhe me Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë ku një pjesë e lëndëve /moduleve kryesisht në vitin e parë, zhvillohen të përbashkëta. [23]</p>

udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Në realizimin e programit japin kontribut edhe departamentet apo njësitë e tjera të institucionit si dhe partnerët me të cilët ai bashkëpunon. [02], [12.2]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknik është përgjegjës për programin e studimit. Ai realizon çdo vit vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit, bazuar në indikatorët themelorë që janë: kurrikula e studimeve, planet mësimore dhe programet mësimore të çdo moduli . [29]. UET realizon analiza të përvitshme të procesit mësimor duke u bazuar në treguesit e standardeve shtetërore të matjes së cilësisë në arsimin e lartë, një prej të cilave është dhe programi i studimit. [50.4, 50.5, 50.6] Departamenti në fillim të çdo viti akademik harton planin e aktiviteteve dhe në fund të vitit bën bilancin e përmbushjes së këtij plani në bashkëpunim me personelin akademik. Në rregulloren e departamentit dhe të programit të studimit janë dhënë detyrat dhe përgjegjësitë ku pjesa më e rëndësishme mbulohet nga njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit. [38], [43] GVJ e vlerëson caktimin e përgjegjës të gruplëndëve/koordinorit të programit mjaft pozitive pasi ndihmon në koordinimin me efikasitet ndërmjet personelit me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme. [36]
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	UET ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh arsimore e shëndetësore vendas [34] në funksion të ofrimit të mundësisë të shkëmbimit të dijeve dhe bashkëpunimit si p.sh QSUT, Spitali Universitar i Traumës, Poliklinika Gjermane, Spitali Salus, Spitali Amerikan, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore etj. [34.1,34.2,34.3,34.4,34.5, 34.6]. Në zbatim të strategjisë së zhvillimit të institucionit [3, 3.1, 3.2, 3.3] dhe marrëveshjeve të nënshkruara, realizohen praktikat profesionale të studentëve, kryesisht me qendrat spitalore në Tiranë. Institucioni të shohë mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimeve me qendra diagnostike rajonale, klinika private etj në qytete të tjera të vendit në mënyrë që tu jepet mundësi studentëve të njihen gjërësisht me tregun e punës por edhe të kenë mundësi të ndryshme për

	kryerjen e praktikave profesionale dhe punësimin e tyre pas diplomimit.[34, 34.1]			
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	<p>Lista e marrëveshjeve të UET apo e departamentit me homologë dhe institucione të huaja dhe vendase, u shërben studentëve kryesisht për realizimin e praktikave profesionale. [34]</p> <p>Në marrëveshjet e bashkëpunimit, janë referuar edhe veprimtari të tjera të cilat janë zhvilluar pjesërisht. Duke konsideruar periudhën e vlerësimit të influencuar nga periudha e pandemisë Covid 19, GVJ konstaton aktivitetet të limituar në veprimtari të tjera akademike dhe shkencore që lidhen me partnerët. Edhe në dokumentin analitik të vlerësimit të përfitimit nga marrëveshjet, (Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, 35), nuk jepen informacione të tjera për aktivitete të organizuara, marrjen pjesë në organizimin e konferencave të ndryshme apo në programet e mobilitetit si rezultat i këtyre marrëveshjeve.</p> <p>GVJ rithekson edhe njëherë se ndikimi i pandemisë Covid 19 ka qenë i dukshëm në organizimin e veprimtarive të tjera në bashkëpunim me partnerët në fushën e programit të studimit. Megjithatë, inkurojojmë personelin akademik të vazhdojë përpjekjet për intesifikimin e veprimtarive të parashikuara në marrëveshjet e bashkëpunimit. [35]</p>			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Rregullorja e programit të studimit parashikon kryerjen e praktikave profesionale në institucione dhe biznese me të cilat UET ka marrëveshje. Në këtë kontekst UET ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private. Praktikant realizohen në, spitale, klinika diagnostike etj. [33.1; 33.2; 33.3; 33.4; 33.5, 36.6]. Studentët gjatë kryerjes të praktikës mbikëqyren nga stafi akademik i institucionit dhe drejtuesi i praktikës në institucionin respektiv. [32.1, 32.2]			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UET ende nuk ka diplomuar studentë në këtë program studimi për tu ofruar trajnime të mëtejshme në fushën e studimit. Megjithatë sikundër theksohet, institucioni e kryen këtë për programet e tjera, dhe do të vijojë edhe me programin në fjalë falë marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve që ai ka [33]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Organizimi i programit bazohet në përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në LAL dhe VKM 41, e ndryshuar. Po ashtu, bazuar në rregulloren e UET [5], programi i studimit Bsc në Imazheri është i organizuar në përputhje me ligjin 80/15 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, programi është i organizuar në module, e lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese, duke i ndarë ato në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplonore dhe plotësuese. [14, 14.1, 14.2].</p> <p>Bazuar në kategorizimin e lëndëve, numri më i lartë i krediteve është vendosur në dispozicion të lëndëve karakterizuese Lëndët e këtij programi janë të vlerësuara me nga 5 - 8 kredite ndërsa praktikat klinike me 5 dhe 7 kredite dhe provimi i përgjithshëm i formimit është vlerësuar me 7 kredite. [14.4]</p> <p>Totali i krediteve që një student merr në përfundim të këtij programi studimi është 180 kredite.</p> <p>GVJ identifikoi se shpërndarja e krediteve për vit akademik nuk është e njëjtë. Kështu v1-59 kredite, v2 59 kredite dhe viti 3, 62 kredite. Ndoshta ky mund të jetë një gabim teknik ose përpjekje për të shpërndarë në mënyrë sa më të saktë lëndët në mënyrë që ato të përputhen me programet e tjera por ne sugjerojmë që kjo pasaktësi të korigjohet në përputhje me aktet ligjore në mënyrë që të mundësohet organizim i saktë i programit dhe lehtësim në procedurat e mobilitetit të studentëve. [14, 14.1-14.4]</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë, Bachelor në Imazheri synon arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e imazherisë. Ato synojnë të sigurojnë njohuritë themelore në këtë fushë nëpërmjet integritit të mësimin me kërkimin. [3.1, 3.2] Modulet/lëndët që ofrohen ju sigurojnë studentëve një përgatitje të gjerë dhe mundësi që të përshtaten në tregun e punës dhe një gamë të gjerë të profileve në studimet e mëtejshme. Në programin janë përfshirë module karakterizuese dhe të përgjithshme të fushës të cilat iu krijojnë studentëve koncepte dhe aftësi të lidhura me specialitetin e tyre. [14.2]</p> <p>Në secilin modul janë përcaktuar edhe rezultatet e të nxënimit për studentët që ndjekin këtë program. [19].</p> <p>GVJ mbështet deklaratimet e dhëna nga departamenti dhe personeli akademik për rishikimin e programit pas diplomimit të parë pasi sikundër është evidentuar, numri i lëndëve të formimit të përgjithshëm është më i madhe se ai i lëndëve profesionale. Po ashtu është e nevojshme futja e disa lëndëve që lidhen me aplikimin e</p>

	<p>teknikave dixhitale në diagnostikë, përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe kompjuterit në imazheri.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit është dizenuar të adresojë nevoja specifike dhe prirje të tregut të punës në imazheri duke iu dhënë mundësi studentëve të punësohen në qendra të ndryshme diagnostike të vendit ose jashtë.</p> <p>Nëpërmjet programit dhe përmbajtjes së moduleve, metodave të mësimdhënies, projekteve dhe detyrave të ndryshme, praktikave etj, synohet që tu japin studentëve njohuri akademike dhe shprehje praktike në fushën e mjekësisë, si dhe koncepte të të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të kësaj fushe. [19]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe praktike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Ai synon pajisjen me njohuritë bazë dhe ka përmbajtje të tillë që tu ofrojë studentëve njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit. [4]</p> <p>Programi siguron aftësi profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve gjatë ushtrimit të profesionit në qendrat diagnostike..</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Imazheri është organizuar në përmbajtje dhe strukturë sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015, përsa i përket krediteve dhe kohëzgjatjes, VKM nr.41. datë 24.01.2018 të ndryshuar, përsa i përket ndarjes së veprimtarive akademike. si dhe akteve të tjera nënligjore apo të brendshme të institucionit. [14]</p> <p>Programi i studimit është organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), realizohet në 3 vite studimi / 6 semestra, me 180 ECTS në total dhe është i strukturuar në grup lëndë sipas kategorive të formimit duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor.</p> <p>Programi përmban 31 lëndë/module përfshirë këtu edhe praktikën profesionale, dhe provimin përfundimtar (7 ECTS). Sikundër kemi theksuar edhe më lart, GVJ ka identifikuar pasaktësinë e ndarjes së krediteve në mënyrë të njëjtë për çdo vit akademik për të cilën institucioni duhet ti reflektojë ndryshimet gjatë fazës së përditësimit të programit.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi ka një shpërndarje deri diku normale të veprimtarive formuese. Megjithatë, gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët u theksua rëndësia për më shumë orë të praktikës profesionale. Edhe pse ka kufizime ligjore në shpërndarjen e këtyre krediteve, orë të praktikës profesionale mund të përfshihen si orë të praktikës lëndore në mënyrë që studentët të plotësojnë kërkesat që ka profesioni i tyre si dhe direktivat evropiane për profesionet e rregulluara.</p> <p>Gjithashtu të shihet mundësia e përfshirjes së disa lëndëve të nevojshme që aplikojnë teknologjinë në imazheri.</p> <p>Në raportet midis veprimtarive formuese në disa lëndë është e paqartë metodologjia mbi të cilën është shpërndarë ngarkesa</p>

	<p>mësimore në auditor dhe jashtë auditorit. Tendenca është gjithnjë në favor të orëve jashtë auditorit duke kaluar në disa raste raportin 1:1. Në këto kushte, GVJ rekomandon që gjatë fazës së rishikimit të programit, të përcaktohet një metodologji e qartë mbi të cilën do të bëhet shpërndarja e veprimtarive formuese, përfshirë orët në auditor dhe jashtë auditorit.</p> <p>Disa module në drejtime specifike si psh të imazherisë hibride, teknologjia e pajiseve mjekësore, teknikave dixhitale, mamografi, inteligjenca artificiale në diagnostikë, lëndë e plotë për radioterapinë etj mund të shihen si alternativa në zvendësimin e disa lëndëve në programin e studimit për të cilat GVJ mendon se nuk japin kontributin e duhur në përgatitjen profesionale të teknikut të imazherisë. [14.2]</p> <p>Konkretisht lëndët: Hyrje në psikologji, Hyrje në filozofi, Neurologji dhe Psikiatri, Metoda kërkimi, Shkrim akademik, etj të shihet mundësia e zvendësimit ose reduktimit të krediteve të tyre në funksion të lëndëve të formimit profesional të teknikut imazherist. [14]</p> <p>Meqënëse vetë institucioni u shpreh për nevojën e rishikimit në përmbajtje të programit pas përfundimit të brezit të parë të studentëve, GVJ sugjeron që grupi i punës që do të ngarkohet në riorganizimin e programit, të konsultohet me programe të ngjashme të ofruara nga universitete të tjera brenda ose jashtë vendit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Programi Bsc në Imazheri ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike i cili përbëhet nga 2 departamente dhe një qendër kërimore. Përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit është departamenti i imazherisë, cili përmbush kriteret ligjore e nënligjore në fuqi sa i përket organizimit dhe personelit akademik [23]</p> <p>Bazuar në të dhënat e institucionit mbi 70% nga personeli efektiv. Personeli akademik është paraqitur me tituj e grada shkencore dhe janë dhënë Cv e tyre [20]. Në tërësi personeli i angazhuar përmbush kriteret ligjore përsa i përket titujve dhe gradave shkencore.</p> <p>GVJ ka identifikuar disa raste të mospërputhjes së fushës së veprimtarisë së personelit akademik me lëndët/modulet që mbulon dhe në disa raste të tjera mbulimin e lëndëve ku titullari i saj nuk zotëron titull akademik. [20], [02]. E ritheksojmë se është evidente pamundësia për të gjetur personel akademik të kualifikuar në këtë fushë studimi edhe pse në direktivat evropiane në mënyrë taksative thuhet se në programet me karakter teknik profesional është e</p>

	nevojshme të angazhohen sa më shumë specialitë të fushës, megjithatë në përmbushje të kërkesave ligjore dhe standarteve të cilësisë, pjesë e Kodit të cilësisë, institucioni duhet të fokusohet në të ardhmen në plotësim e këtyre kërkesave.			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatorit i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Dekani i Fakultetit cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij [36]. Koordinatorit i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse qoftë nëpërmjet takimeve verbale apo në takime të tjera. Ai shqyrton cilësinë e syllabuseve përpara miratimit të tyre, miraton temat e eseve, tezat e provimeve, vlerëson ecurinë e zhvillimit të praktikave profesionale etj [19] Detyrat e koordinatorit përcaktohen në aneksin e vendimit çka ë disa raste, e bën të paqartë rolin e tij n pasi kompetencat e tij mbivendosen me ato të përgjegjësit të departamentit [36]			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin BSc Imazheri , përmbush detyrimet ligjore për të ofruar programin e studimit. [02]. Organizimi dhe strukturë akademike është nga tre njësi bazë: dy departamente dhe një qendër kërkimore në Shëndet Publik, Njësitë kryesore dhe bazë përmbushin detyrimin ligjor për numrin e personelit dhe tituj akademikë.[6]			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Njësia përgjegjëse për forimin e programit të studimit, është Departamenti i Imazherisë. Në përbërjen e vet ky departament ka gjithësej nga 8 anëtarë, ku 7 janë me kohë të plotë, 4 Dr. dhe 3 asistentë lektorë dhe 1 personel akademik me kontratë, Msc. Stafit i angazhuar është kryesisht i ri por ka edhe me eksperiencë në mësimdhënie duke realizuar kështu një ndërthurje midis personelit të ri dhe atij me eksperiencë. [02] GVJ thekson se departamentit i nevojitet personel akademik i fushës së imazherisë i kategorisë profesor sikundër u theksua edhe nga vetë drejtuesit e departamentit në takimin me ta.			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Departamenti i Imazherisë, përmbush kriteret ligjore për numrin (7) dhe titujt akademik të nevojshëm për njësinë bazë . Edhe pse në dokumente thuhet se personeli organizohet në grup-lëndë, ku grupohen anëtarët e Departamentit (grupet kërkimore shkencore), GVJ nuk evidentoi veprimtari të cilat mbështesin këtë ndarje të personelit akademik.[02], [6], [7]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>FSHMT si njësia kryesore përgjegjëse për organizimin e programit të studimit Bachelor në Imazheri, disponon dokumentacionin e plotë për programin e studimit ku përfshihen: Kurrikula e programit të studimit; Plani mësimor; syllabuset e lëndëve. Ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese jepen e detajuar në planin mësimor të programit të studimit bazuar në kërkesat e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”, e ndryshuar</p> <p>GVJ identifikoi si praktikë të mirë përgatitjen e një pjese të mirë të dokumenteve edhe në gjuhën angleze çka mundëson jo vetëm lehtësime për transferimin e studentëve por ndihmon studentët të orientohen në gjetjen e materialeve shtesë në internet dhe shfrytëzimin e literaturës online.[19]</p> <p>Ndërkohë informacioni i programit gjendet në sistemin LMS dhe në faqen e internetit të universitetit. [462, 46.3]</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit ka të ndara lëndët sipas kategorive nga A-E. Bazuar tek kjo ndarje, [14.4], persha e secilës kategori jepet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) 15% - 20% (32kredite), 7 provime - Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (B) 50% - 55% (93 kredite), 13 provime - Lëndë ndërdisiplinore/ integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) 12% - 15% (34 kredite), 6 provime - Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) 10% - 15% (26 kredite), 5 provime - Detyrime përmbyllëse (E) 3% - 5% (7 kredite), [14] <p>Për çdo lëndë modul jepen, detyrimet respektive (seminare, ushtrime, punime, detyra kursi, projekte, praktikë);</p> <p>Në syllabuset e lëndëve/moduleve, jepet mënyra e kontrollit të dijeve. [19]</p> <p>GVJ rithekson nevojën për rishikimin e lëndëve dhe moduleve të kategorive A, B dhe D për të mundësuar një profil sa më profesional të programit në fushën e imazherisë.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Emërtimi i lëndëve/moduleve të grupuara sipas kategorive jepet me kreditet respektive</p> <p>Numri i krediteve për çdo lëndë/modul dhe raporti i orëve (leksione seminare, laboratorë), jepet i detajuar në planin mësimor [14.2]</p> <p>Secila lëndë/modul përmban kreditet respektive dhe të ndara në auditor dhe jashtë auditorit.</p> <p>Për GVJ është e paqartë se mbi çfarë metodologjie është bërë ndarja respektive e krediteve në auditor dhe jashtë auditorit.</p> <p>Në metodologjinë e organizimit të veprimtarive akademike në nivel institucional, nuk del qartë mekanizmat e shpërndarjes së ngarkesës në nivel lënde për çdo veprimtari. Megjithatë, gjykojmë se programi i studimit ka specifikat e veta si pjesë e fushës së mjekësisë dhe</p>

	mbivendosja e parashikimeve të dhëna nga personeli akademik në syllabuset e lëndëve, mund të shkaktojë paqartësi tek studentët.						
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Plani mësimor hartohet nga Përgjegjësi i njësisë bazë dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. [14.2] Programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulën, kursin dhe semestrin kur zhvillohet, karakterin e modulit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti; kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit dhe literature. Syllabuset janë të përkthyer edhe në gjuhën angleze						
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Pranimi i studentëve në programin e studimit Bsc Imazheri është i përcaktuar në Rregulloren e programit, dhe politikat e pranimit në UET [7], [27.1] Transferimi i studimeve po ashtu parashikohet dhe mbështetet në Rregulloren e FSHMT dhe atë të programit të studimit, ku përfshihen transferimi i studimeve, transferimi i studimeve në të njëjtin cikël studimi, procedurat e transferimit, si dhe Ekuivalentimi i programeve të studimeve për studentët që transferohen. Rregullore e UET si dhe ajo e programit të studimit parashikon dhe rregullon edhe transferimet dhe ekuivalentimin e studimeve edhe drejt IAL-ve të tjera [7]. Sikundër kemi theksuar, institucioni në fazën e kryerjes së ndryshimeve të parashikuara të marrë në shqyrtim programe të njëjtë ose të përafërta në mënyrë që organizimi i programit dhe shpërndarja e veprimtarive të bëhet në mënyrë të tillë që të mundësojë transferimin e studentëve (in-out).						
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit, përmban informacionin e nevojshëm, ku përfshihen syllabuset e lëndëve të prezantuara sipas kërkesave të VKM 41, dt.24.01.2018 [19], [www.uet.edu.al] në të cilat paraqitet për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara, në shqip dhe anglisht Plani mësimor i detajuar sipas përcaktimeve të VKM, paraqet informacionin e nevojshëm për studentët dhe personelin akademik,[14.2]						
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Programi i studimit Bsc Imazheri diplomon studentët e parë. Ai nuk është përditësuar pa kaluar akreditimin e tij të parë. Ndërkohë disa rekomandime janë plotësuar në fazën e licensimit të tij [18]. Sikundër kemi përmendur edhe në kritere të tjera që lidhen me përmbajtjen e programit, është e nevojshme një rishikim i përmbajtjes dhe riorganizim i lëndëve/moduleve për ta përmirësuar programin duke reflektuar kërkesat e reja që zhvillimi i teknologjisë në pajisjet diagnostike sjell. Ky konkluzion është nxjerrë edhe nga vetë përfaqësuesit e departamentit. Ndërkohë syllabuset bazuar tek deklaratimet e stafit, janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm, [59, takimi me stafin akademik].						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor për programin e studimit Bsc në Imazheri është organizuar sipas VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, e ndryshuar, por duke i dhënë peshë më të madhe orëve jashtë auditorit.[14.2]. Edhe pse nuk ka një udhëzim të qartë se si përcaktohen raportet midis orëve në auditor dhe jashtë auditorit, ajo llogaritet në mënyrë indirekte nga koncepti i kreditit dhe ekuivalenca e tij në 25 orë mësimore në total. Gjithashtu është evidentuar mospërputhshmëria e krediteve në çdo vit akademik në 60 kredite. GVJ rithekson nevojën për përmirësime eventuale në përmbajtje të programit
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në Imazheri, janë ndërtuar në mënyrë të tillë për të ofruar një bazë të gjerë njohurish në fushën e shkencave mjekësore, dhe u mundësojnë studentëve punësimin në fushën e imazherisë [4] Komponentët mësimorë si mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime apo laboratorë si dhe kontrolli i vazhdueshëm) është në funksion të interaktivitetit të studentëve me pedagogun e lëndës dhe në funksion të stimulimit të mendimit të tyre krijues/novator dhe praktik. [32.1]
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë [14.2]. Lëndë të caktuara, varësisht nga specifikat, mund të aplikojnë seminare klasike ose mund të aplikojnë detyra/projekte kursi, praktikë lëndore me studentët për ti nxitur ata të krijojnë në mënyrë të pavarur, ndërkohë në lëndë të tjera mund të aplikohen më shumë orë laboratorike ose praktikë (praktikë lëndore). Kjo do të jetë pjesë e analizës dhe përmirësimeve të mundshme të programit në të ardhmen duke reflektuar edhe propozimet e studentëve të diplomuar [59, takimi me studentë]
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit Bsc në Imazheri, është organizuar sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. dt. 24.01.2018 dhe udhëzimet e MAS. Lëndët dhe raporti i tyre praktik teori është përcaktuar dhe miratuar nga autoritetet drejtuese të UET në fazën e licensimit dhe miratuar nga MAS. [16],[54] GVJ gjykon se raporti teori praktikë ka nevojë për rishikim nëse i referohemi direktivave evropiane ku kërkohet më shumë kredite për

	<p>praktikën profesionale. Sikundër kemi theksuar, është e nevojshme përafrimi i programit me programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Struktura e programit të studimeve Bachelor në Imazheri është organizuar sipas VKM 41.dt.24.01.2018, e ndryshuar, pika 2.5, ku përcaktohen qartë veprimtarisë formuese. Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një modul. Lëndët, modulet ose veprimtaritë formuese ljanë organizuar me qëllim formimin e studentit në përputhje me qëllimin dhe objektivat që ka programi. Përmirësimi i mëtejshëm i programit rrit mundësinë e transferimit apo mobilitetit të studentëve e për më tepër të mundësive për punësim pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Meqënëse programi është në fazën të implementimit të tij, rishikimet në kuadër të përmirësimit, janë të nevojshme</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Sipa deklarimeve, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike analizon ecurinë e programit të studimit, duke përfshirë në të mendimin dhe opinionin e lektorëve por edhe të studentëve lidhur dhe me programin e çdo moduli. [38], [41].</p> <p>Syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë konform këtyre përcaktimeve duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës [19]. Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë të detyrueshme dhe literature ndihmëse. Pjesën kryesore të literaturës e zënë botime në gjuhën angleze nga shtëpi botuese të njohura si Oxford University Press, Cambridge University Press, McGraë-Hill, Oxford, Pearson, Sage, Cambridge, McGraë-Hill, etj. [45], [45.1]</p> <p>Në fillim të semestrit, syllabuset e lëndëve rishikohen nga titullari i lëndës, konsultohen nga Përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit.</p> <p>GVJ konsideron mjaft pozitive përdorimi i literaturës së huaj si pjesë të literaturës bazë dhe asaj të huaj. Megjithatë ende nuk ka botime, tekste në shqip me literaturën e plotë por studentët kryesisht marrin përmbledhje të leksioneve të përgatitura nga lektorët. [19]</p> <p>Në të ardhmen institucioni të shohë mundësinë e përshtatjes në shqip të disa prej botimeve kryesore të fushës së imazherisë në mënyrë që studentët të thellojnë njohuritë e tyre. [45-a,b,1,2,3]</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Studentët pas përfundimit të studimeve në ciklin e parë Bsc në Imazheri, janë të pajisur me dije dhe aftësi për; tju përgjigjur nevojave që kanë institucionet shëndetësore, qendrat, spitalore etj, ku ata mund të aplikojnë teknika të reja të avancuara në përputhje me dijet e fituara në këtë cikël studimi. Po ashtu njohuritë e fituara janë në përputhje me nivelin 6 të KSHK. [32.1]</p>


<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Imazheri është në përputhje me përcaktimet e bëra në vizionin dhe misionin e fakultetit dhe UET, si një institucion bashkëkohor studimi, kërkimi dhe transferimi të njohurive. [31, 3.2]. Programi i studimit është në mbështetje të nevojave dhe kërkesave për këtë kategori të diplomuarish në shkencat mjekësore teknike.</p> <p>Të diplomuarit në këtë program studimi mund t'i përgjigjen mjaft mirë nevojave të vendit, duke qenë të aftë për tu punësuar veçanërisht në: qendra mjekësore, klinika diagnostike, spitale, qendra të shëndetit, poliklinika etj.</p> <p>Përmbajtja e Programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Imazheri, ka përmbajtje të tillë që tu ofrojë studentëve njohuritë bazë të nevojshme për ndjekur më tej ciklet e tjera të studimit, Master Profesional apo dhe Master Shkencor në teknik imazherie ose teknik radioterapie. [4], [14.2]</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Në kuadër të politikave favorizuese të punësimin të studentëve, Departamenti merr në konsideratë mendimet, propozimet e anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës dhe konsultohet me ta, për përmirësimin e programit të studimit me qëllim lehtësimin e përfshirjes së studentëve në tregun aktual të punës. [12.1], [34.1]</p> <p>Marrëveshje të cilat kanë në fokus realizimin e praktikave të studentëve dhe punësimin e tyre. Në këto marrëveshje, jepet mundësia jo vetëm e praktikimit por edhe të mundësive të punësimin në të ardhmen. Pas përfundimit të kësaj fazë të parë të forimit të programit, analiza e plotë përfshirë edhe tregun e punës dhe punësimin e studentëve, do të ndihmonte në oreintimin e programit sa më qartë drejt aftësimin profesional dhe epunësimin të studentëve. [32.1]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Pesoneli akademik me kohë të plotë dhe më kohë të pjesëshme që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në Imazheri i plotëson kërkesat ligjore përsa i përket numrit, titujve dhe gradave.[02], [20] Në realizimin e programit të studimit angazhohen personel me kohë të plotë, më kohë të pjesëshme dhe të ftuar [02] Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme i përmbush kërkesat ligjore që rjedhin nga ligjit 80/2015. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënien e programit të studimit për leksione dhe seminare zotëron titujt dhe grada sipas përcaktimeve</p>

	<p>ligjore, ndërsa për praktikat dhe ligjore angazhohen personel ndihmës akademik minimalisht të diplomuar në ciklin pasardhës të studimeve Bachelor.</p> <p>Konkretisht për tre vitet e fundit janë angazhuar: [02]</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2018-2019, përbëhet nga 12 staf akademik efektiv, nga të cilët: 1 Prof. Dr., 4 Dr. dhe 7 MSc, dhe 2 staf akademik me kontratë, nga të cilët: 1 Prof.Dr. dhe 1 Prof. As.Dr. - 2019-2020, stafi i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit është: 16 staf akademik efektiv, nga të cilët: 1 Prof.Dr., 7 Dr./PhD., 8 Asistentë lektorë MSc; dhe 5 staf akademik me kontratë, 1 me titull Prof. Dr., 2 m titull Prof.As.Dr, 1 me gradën shkencore Dr. Dhe 1 Asistent lektor me MSc. - 2020-2021, stafi i angazhuar në program ka këtë përbërje: 17 staf akademik efektiv, nga të cilët 1 Prof.Dr., 1 Prof.As.Dr., 8 Dr/PhD, 7 asistent lektorë me MSc., si dhe 4 personel akademik me kontratë, nga të cilët: 2 Dr, 2 MSc.
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Refruar CV të stafit akademik, drejtimi dhe specialiteti i tyre në përgjithësi përputhet me drejtimin e programit të studimit Bsc në Imazheri.</p> <p>Sikundër kemi theksuar, GVJ ka identifikuar raste ku fusha e veprimtarisë së personelit akademik nuk përputhet plotësisht me profilin e lëndëve/moduleve apo angazhimin e tyre në këtë program studimi.</p> <p>GVJ sugjeron rekrutimin në të ardhmen e personelit me tituj e grada shkencore të fushës së imazherisë për të mbuluar veprimtari të formimit teorik dhe profesional të imazherisë.[23], [26].</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Në përgjithësi anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë dhe ata me kohë të pjesëshme, që angazhohen në mësimdhënie kanë të gjitha kualifikimet dhe kompetencën për të zhvilluar me cilësi të lartë programin e lëndës. [23], [26].</p> <p>Në CV-të e stafit gjen fushat e tyre të interesit dhe kërkimit që përputhen me natyrën e moduleve që mbulojnë në këtë program studimi Megjithatë, sikundër përmendëm më lart, GVJ mendon se ka nevojë për rishikim të shpërndarjes së ngarkesës në funksion të profilit dhe të rekrutohet personel akademik i fushës së imazherisë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera</p>	<p>Sipas rregullores së programit, departamenti harton programin e praktikës profesionale sipas modelit përkatës si dhe cakton stafin akademik që do të drejtojnë zhvillimin e praktikës në objekt. [02]. Mbikëqyrja dhe ndjekja e këtyre seancave kryhet nga një pedagog, i caktuar nga departamenti, i cili ka edhe statusin e këshilluesit të karrierës Stafi akademik përgjegjës në përfundim të praktikës profesionale, dorëzon në departament përmbledhje të dokumentacionit mbi kryer në institucione të të ndryshme sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe drejtohet nga pedagogu i caktuar nga departamenti.</p> <p>Institucioni ka një sërë marrëveshjes bashkëpunimi me institucione</p>



specifike sipas natyrës së programit të studimit.	të ndryshme shëndetësore që ofrojnë shërbimin e imazherisë. GVJ identifikoi se institucioni ende nuk ka infrastrukturë të mirëfilltë laboratorike ku mund të zhvillohen disa nga temat e praktikës profesionale veçanërisht dedikuar imazherisë dixhitale dhe metodave të përpunimit imazheve mjekësore. Nëpërmjet një projekti është krijuar laborator i simulimit VR i cili përdoret njëkohësisht edhe për simulimet anatomike dhe modelet e anatomisë radiologjike çka konsiderohet mjaft pozitive nga ana jonë.[42, 42.1]			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit që ofrohet [42.1] Po ashtu për Programin e studimit Bachelor në imazheri përdoren kryesisht infrastruktura jashtë institucionit për formimin praktik të studentëve. Gjatë këtyre orëve krahas pedagogut të lëndës asistojnë edhe stafi ndihmës akademik që janë përgjegjës për këto laboratore. Angazhimi i stafit ndihmës vlerësohet pozitiv pasi janë teknikë imazherinë me eksperiencë që aktualisht punojnë edhe në qendra diagnostike. [02]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Universiteti Evropian në nivel institucional ka hartuar udhëzues të për disa procese që lidhen me mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme, hartimin e silabuseve, unifikimin e metodave të mësimdhënies, përzgjedhjes së literaturës, sistemin e kontrollit dhe vlerësimin të dijeve të studentëve, këshillimin akademik dhe tutoriatin etj [5, 5.1, 5.2, 5,3]. Pjesë e rëndësishme janë edhe aktivitete të adresuara për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies sikundër kanë qënë udhëzimet për zhvillimin e mësimdhënies gjatë pandemisë, apo metodat e zhvillimit të mësimdhënies online nëpërmjet LMS.[46.1]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës-akademik realizohet në mënyrë periodike nga institucioni. [30.3], [29]. Ky proces realizohet përmes disa instrumentave: Instrumenti i parë, dy herë në vit në përfundim të çdo semestri zhvillohet pyetësori me studentët. [7.2] vetvlerësimi. Vlerësimet e KSBC, vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimin të Performancës etj
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Vlerësimi i pedagogut dhe lëndës nga studentët që kryhet në fund të çdo semestri, me studentët, si dhe përmes mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit; dokumenti i performancës, ku stafi akademik dokumenton ngarkesën mësimore, performancën në kërkimin shkencor dhe botime e shërbime ndaj të tretëve. Instrumenta të tjerë përdoren edhe nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse së personelit akademik dhe ndihmës-akademik. [30.1] Në takime u theksua se studentët kanë të drejtë të shprehin ankesat e tyre në takimet e hapura të departamentit, pranë Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit, Departamentit dhe Sekretarit të Përgjithshëm. Megjithatë, në lidhje me vlerësimin e performancës së personelit, GVJ konstatoi se vlerësimi kryhet në mënyrë të përgjithshme dhe jo individuale. Për më tepër rezultatet e vlerësimin ende nuk janë pjesë e politikave stimuluese apo promovuese për personelin akademik në funksion të performancës së tij. Nga takimi me përfaqësuesit e KSBC u theksua fakti se ato bëhen por për shkak të pandemisë shumë veprimtari në fushën e sigurimit të cilësisë janë fokusuar kryesisht tek mësimdhënia online dhe monitorimi i saj.[59]

<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>KSBC në rolin e strukturës përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë bën publike rezultatet e anketave nëpërmjet analizës vjetore të departamentit dhe fakultetit.[30.3]. Vetëm pas diskutimeve në departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet në departament dhe përcillet në dekanat. Sikundër e theksuam, nuk ka të dhëna të detajuara lidhur me vlerësimet individuale. Edhe në raport (fq.20), nuk jepet informacion për publikimin e raporteve të vlerësimit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni deklaron se të dhënat e përfituara nga mekanizmat e vlerësimeve periodike shërbejnë jo vetëm për analizimin e situatës dhe identifikimin e problemeve, por ka si synim kryesor marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë por pa dëshmuar si përdoren këto vlerësime për këtë qëllim.. [29] UET ka eksperiencë të gjatë në sistemet e vlerësimit të brendshëm apo të jashtëm çka ka ndihmuar institucionin të reflektojë apo përmirësojë njaft nga treguesit, rekomandimet e dhëna në vlerësime të mëparshme. GVJ identifikoi pozitive veprimtarinë e KSBC lidhur me sigurimin e cilësisë, nxitjen e inkurajimit e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. [30, 30.1, 30.5]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Referuar syllabuseve të programit të studimit Bsc në Imazheri dhe planit mësimor, format e mësimdhënies dhe të transferimit të dijeve janë leksionet, seminarët, projektet, detyrat e kursit, laboratorët dhe praktika. [19] Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive sikundër është parashikuar edhe në VKM 41, të ndryshuar, janë leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat profesionale e klinike, etj të cilat realizohen në përputhje me planin mësimor. Çdo syllabus e ka të përcaktuar qartë formën dhe metodologjinë e mësimdhënies e cila ndryshon nga lënda në lëndë dhe duke respektuar lirinë akademike.[19] Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, ku studentët kanë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit Institucioni ka hartuar një udhëzues për unifikimin e vperimtarive akademike në nivel institucional i cili konsiderohet praktikë e mirë nga ana e GVJ.</p>

<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik përdor forma të mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve. Këto forma parashikohen në rregullore, syllabuse dhe programin e studimit. [19]</p> <p>Në përfundim të çdo lënde/moduli, është parashikuar zhvillimi i provimit përkatës. Format e kontrollit të dijeve: testimet ndërmjetëse, punët laboratorike, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit, provimet e formimit etj. Personeli akademik ofron mundësi për studentët në përvetësimin e lëndëve, njohurive dhe aftësimit praktik.</p> <p>Personeli akademik ka kontakte të vazhdueshme me studentët dhe i asistojnë ata në zgjidhjen e problematikave apo sqarimin e pyetjeve të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, personeli akademik përdor forma të ndryshme të cilat mirëpritën nga studentët. Infrastruktura në dispozicion të personelit akademik lejon mundëson përdorimin e teknologjisë dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies [46.1]</p> <p>Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm dhe aplikimit të formave më të reja të mësimdhënies, UET ka patur përdorur LMS edhe para pandemisë Covid 19 çka lehtësuar kalimin në mësimdhënien online.[5.1] Ndërkohë ka investuar në teknologji të reja, sic është laborator i infomatikës i pajisur me pajisjet VR për anatominë virtuale.</p> <p>Personeli akademik trajnohet vazhdimisht ku institucioni organizon Ditën e Zhvillimit të Stafit, me synim trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin etj</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit, Bachelor në Imazheri plotëson kriteret ligjore të kualifikimit të përcaktuara nga ligji 80/2015. Referuar CV, personel akademik, zotëron kompetencat e nevojshme për shpjegimin njohurive të këtij niveli studimi. [20]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Rezultatet e Anketimeve të rezizuara nga KSBC me studentët dhe konsultimet e realizuara në department midis stafit akademik i shërbejnë personelit akademik të programit të studimit për të përmirësuar format e mësimdhënies duke përfshirë edhe mendimet e studentëve. [30.5] Mendimet lidhen me ndryshime në programin e një lënde të caktuar, me ndryshime të kurrikulës së programit, ose me ndryshim të personelit akademik që zhvillon lëndën, në rastin kur konstatohet se pedagogu nuk ka kompetencën dhe aftësitë e duhura për të vijuar angazhimin por që nuk u identifikuan raste të tilla nga ana e GVJ</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Personeli akademik është i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Komunikimi i</p>

	drejtpërdrejtë me studentët mundëson marrjen shpejt të mendimit të tyre. Zhvillimi i orëve interaktive zhvillimin intensiv të procesit të angazhimit të studentëve. Diskutimet, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet janë disa nga instrumentet kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve.[46.2, 46.3]			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Profili i programit të studimit, i jep mundësi studentit të japë në mënyrë të pavarur njohuritë e tij dhe ti zbatojë ato në praktikën profesionale. UET ofron literaturë në gjuhë të huaj çka nxit studentët për të kërkuar më shumë në internet të mbështetur edhe nga pedagogët duke rritur në këtë mënyrë interaktivitetin e tyre për të siguruar burime alternative informacioni. [45a, 45b]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	UET zhvillon veprimtarinë e vet në një ambient të ri i përshtatur për të plotësuar nevojat që ka institucioni në ofrimin e programeve të studimit dhe zhvillimin e veprimtarive të tjera akademike. [42.1] Sipas deklarimeve të institucionit, janë në dispozicion 15 salla leksionesh me sipërfaqe totale 1447 m ² dhe 13 salla seminari gjithsej, me sipërfaqe 561 m ² të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë etj.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Procesi mësimor për programin e studimit BSc. Imazheri zhvillohet në ambiente sic janë sallat e leksioneve, seminareve. Në funksion të studentëve, janë mjediset e tjera si salla informatike, biblioteka dhe ambiente të tjera që përdoren edhe në funksion të programeve të tjera. [42.1]
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Sikundër kemi përmendur, UET ka një informatizim të mirë të institucionit. Laboratorë informatike, rrjet kompjuterik, internet, sistem për menaxhimin e mësimdhënies në distancë si UET-LMS, janë vënë në funksion të studentëve. [46.2, 46.3] GVJ identifikoi si të nevojshme krijimin e hapësive laboratorike për zbatimin e njohurive të imazherisë dixhitale. Edhe personeli akademik konfirmoi se është e nevojshme krijimi i një laboratorit për përpunimin e imazheve dixhitale dhe se janë duke punuar në këtë drejtim. GVJ sugjeron që fillimisht të bëhen reflektimet e nevojshme në programin e studimit me lëndë/modul që përfshin teknikat dixhitale

	dhe mandej të përshatet infrastruktura respektive me programe të dedikuara për përpunimin dhe simulimin në imazhevrinë mjekësore.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni u siguron studentëve të programit të studimit Bsc në Imazheri, materiale përmbledhëse si dhe literaturën e rekomanduar në gjuhën angleze [45] Botimet në shqip në fushën e imazherisë janë të limituara dhe sipas deklarimeve të stafit, janë duke hartuar përmbledhje dhe përshtatje të literaturës Materialet e përgatitura u jepen studentëve në mënyrë fizike ose elektronike nëpërmjet LMS. Materialet gjenden në formë elektronike në bibliotekën e institucionit e cila ka akses / abonim në libraritë elektronike Sage&Ebsco si edhe Questia. Ndërkohë biblioteka është pjesë e sistemit COBISS.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit u identifikuan botime kryesisht të lëndëve paraklinike dhe më pak në drejtimin e imazherisë mjekësore. Biblioteka e UET pasurohet me botime të reja periodike të cilat u vihen në dispozicion edhe studentëve. Materialet në formatin print ose elektronik mund të aksesohen nga studentët në bibliotekë. Orari i Bibliotekës është nga e Hëna-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00- 17:00 dhe gjatë sezonit të provimeve funksionon me orar të zgjatur. Biblioteka është kataloguar me libra elektronik në gjuhë të huaj, çka mundëson gjetje të shpejtë të tyre. [45, 45.1, 45.2]
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë online që mundësohen nga institucioni. Stafi i bibliotekës ofron mbështetje për gjetjen e burimeve ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë dhe akses në Questia, Social Science Library, Sage. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online).
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	UET disponon salla të pajisura me PC dhe projektor, laboratorë informatike etj. Infrastruktura laboratorike në fushën e imazherisë është e limituar. Kryesisht nevojat që kanë studentët mbuloohen në institucionet partnere me të cilat UET ka marrëveshje bashkëpunimi. [34] Gjithsesi, infrastruktura laboratorike në imazherinë dixhitale, teknikat e përpunimit imazherik dhe përdorimit të teknologjisë në mjekësi, duhet të përmirësohet në të ardhmen.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	UET në funksion të mësimdhënies, përdor platformën online UET LMS. Kjo platformë është krijuar nga viti 2017. Pandemia Covid 19 nxiti në mënyrë masive përdorimin e kësaj platforme për zhvillimin e procesit mësimor online duke përdorur UET LMS, Teams etj.[46, 46-1-2-3-4-5] Ndërkohë platforma përdoret për shpërndarjen e materialeve tek studentët, kryerjen e testeve, për komunikim midis studentve dhe pedagogëve etj.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë	Nëpërmjet UET LMS, shkëmbehen materiale, njoftime dhe informacion që lidhet me lëndët.

sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Studentët deklaruan se kanë akses tek materialet e ngarkuara nga pedagogu i lëndës, kanë mundësi të komunikojnë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe studentët e tjerë, të shohin vlerësimet e tyre, të krijojnë grupe pune etj. [59, takimi me studentë]			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Sic reflektohet edhe në rregulloren e fakultetit dhe departamentit, ve në dispozicion të studentëve listen me temat e diplomave, të cilët më pas me ndihmën e pedagogut përgjegjës për ndjekjen e tij gjatë hartimit të temës së diplomës, i cili miratohet nga Dekani i Fakultetit, zgjedhin temën të cilën ata e konsiderojnë të përshtatshme. [10] I gjithë procesi, nga aplikimi deri tek dorëzimi i punimit dhe mbrotja e temës, është i rregulluar në mënyrë të detajuar. Pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike për të asistuar dhe mbështetur studentët gjatë fazës së shkrimit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	KSBC është njësi përgjegjëse në nivel institucional që promovon përmirësimin e mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkëpunon me njësitë e tjera të UET në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore e kërkimore dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme. [30.1] GVJ konstaton se UET ka të konsoliduar sistemin e sigurimit të cilësisë për shkak të një ekspërience të gjatë në proceset e akreditimit [30.3]. Këtë vit akademik UET është duke zhvilluar procesin e riakreditimit institucional me agjencinë britanike QAA duke mundësuar në këtë mënyrë një konsolidim të mëtejshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë.
Kriteri 2. Njësi kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamenti i imazherisë është njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit. Përmes kontrolleve të vazhdueshëm, planit të aktiviteteve të personelit akademik dhe anketimeve të studentëve, në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera të Akademisë, sic janë KSBC etj. [30.1] Drejtuesi i departamentit përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore, miraton ndryshimet në syllabuse, vlerëson performancën e stafit dhe administron veprimtaritë e departamentit. [6]

<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Bsc në Imazheri organizohen në takime dhe orë të hapura për implementimin në praktikë të të reja të fundit të teknologjisë, aplikimin dhe nxitjen e projekteve dhe praktikave inovative.</p> <p>Programi është në fazën e parë të zbatimit të tij dhe pas akreditimit të parë dhe ndryshime në kuadër të përmirësimit në përmbajtje dhe në metodologjinë e veprimtarive akademike do të jenë pjesë e ndryshimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti mbështet vazhdimisht me politikat integruese të personelit akademik duke i dhënë atyre mundësinë për trajnime të ndryshme në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Të njëjtën politikë UET ndjek edhe për personelin ndihmës akademik, duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre UET, ashtu edhe jashtë UET. [55.1]</p> <p>Në fushën e imazherisë, UET nuk ka ofruar programe të ciklit të tretë apo ofrimin e titujve akademikë.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni integron stafin në jetën e tij sociale duke organizuar evente të ndryshme si: promovimi i librave; organizimi i tryezave të debatit me aktorë të ndryshëm të biznesit, për çështje të ditës; pjesëmarrja e personaliteteve të ndryshme nga fusha të caktuara të shkencës, festa të ndryshme etj. Strategjia e zhvillimit të UET, ndër prioritetet kryesore ka kualifikimin e mëtejshëm të stafit të saj akademik. [3.1, 3.2].</p> <p>UET, nxit vazhdimisht kualifikimin e stafit akademik, e fokusuar në organizimi i konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, Promovimi i personelit akademik, nëpërmjet mbështetjes financiare në aktivitete të ndryshme shkencore dhe trajnuese, mbështetja financiare për hartimin e teksteve të ndryshme mësimore, në formën e librave apo leksioneve të shkruara etj. Ndërkohë gjatë pandemisë janë zhvilluar trajnime për mësimdhënien online, janë vënë në dispozicion materiale dhe udhëzues të ndryshëm për rritjen e aftësisve në përdorimin e UET-LMS. [59, takimi me stafin akademik]</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për ecurinë e punës kërkimore shkencore dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore duke respektuar lirinë akademike dhe kërkimore të personelit akademik. [1] Institucioni ka ofruar mbështetje që konsiston në përdorimin e laboratorëve dhe faciliteteve të tjera në zbatimin e metodave të reja për përmirësimin e mësimdhënies sikundër është infrastruktura IT, platforma edukimi, libraritë online, udhëzuesit etj. [3]</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitet përgjegjëse.</p>	<p>Në mënyrë periodike vjetore fakulteti dhe departamenti analizon punën kërkimore dhe mësimore duke nxjerrë në pah arritjet dhe mangësitë si dhe përcakton ecurinë për të ardhmen. Diskutohen përdorimi i metoda të reja në mësimdhënie si: performanca e punës kërkimore e të gjitha llojeve të angazhimeve në nivel departamenti në lidhje personelin akademik, në nivel individual paraqitet dhe vlerësohet nga organet drejtuese të institucionit e paraqitur</p>

	<p>nëpërmjet raportimeve periodike në analizat e punës kërkimore. [38]</p> <p>GVJ identifikoi si praktikë të mirë bashkëpunimin dhe partneritetin e stafit akademik të fakultetit me kolegë brenda institucionit si dhe të institucioneve të tjera homologe. Nxitja e këtyre bashkëpunimeve dhe partneriteteve shërben për rritjen e cilësisë dhe performancës e stafit por edhe ngritjen në një nivel më të lartë transmetimin e dijeve tek studentët (praktika të reja mësimdhënie, potencialisht mjete të reja mësimdhënie, metoda të reja të përfshirjes së studentëve në diskutim (interaktivitet më intensiv).[40, 41]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
				X

Standardi III.5
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve për programin e studimit Bsc në Imazheri, përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, në syllabuset e lëndëve dhe në metodikën e zhvillimit të veprimtarive akademike. [19], [32.2]</p> <p>Këto kritere përfshijnë, vlerësimin e studentit gjatë gjithë vitit me anë të punës në auditor, përgatitjes së detyrave të kursit, punëve laboratorike, praktikave profesionale dhe provimit përfundimtar. Mënyra e vlerësimit jepet në mënyrë të detajuar në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të lëndës. Një pjesë e informacionit është publikuar në LMS dhe në faqene internetit të universitetit. Informacione jepen edhe në fillim të lëndës ose modulit. [46.3]</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të çdo semestri pedagogu përkatës në orën e parë të vitit akademik, i informon studentët mbi përmbajtjen e lëndës, temat që do zhvillohen mënyrën e vlerësimit etj, duke i njohur kështu studentët më syllabusin e lëndës. [12], [27.1]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, [7] testimi i dijeve dhe njohurive të studentëve gjatë nje semestri ose viti akademik realizohet përmes detyrave të kursit, projekteve , punëve laboratorike, praktikës profesionale, provimeve të ndërmjetme dhe provimin përfundimtar, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të ndryshme për të shpalosur njohuritë e tyre. [7.3] Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës/modulit bëhet sipas modelit të detajuar nga departamenti (gjithsej 100 pikë), por</p>

	mbetet në kompetencë të pedagogut përgjegjës të lëndës përcaktimi i peshës specifike për secilin komponent të mësimdhënies (leksione, seminare/ushtrime, laboratorë dhe provim përfundimtar. [19] GVJ rithekson paqartësinë që ka evidentuar në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së ngarkesës mësimore sipas veprimtarive formuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Studentët e programit të studimit Bsc. Në Imazheri, testohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik me anë të projekteve, detyrave, punëve të laboratorit, provimit të ndërmjetëm dhe atij final. Format dhe mënyrat e vlerësimit i bëhen të ditura studentëve që në fillim të lëndës. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UET është duke vënë në funksionim sistemin elektronik të kontrollit të dijeve (provimeve finale dhe testeve të ndërmjetme) në mënyrë që të reduktojë në maksimum abuzimin dhe subjektivitetin në vlerësimin e studentëve. Korrigjimi elektronik Clean Score, është duke u mundësuar në bashkëpunim me AADF [59, takimi me zyrat mbështetëse]
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në aktet rregullatore, përcaktohen modalitetet e provimit dhe përbërja e komisionit në drejtimin e titullarit të modulit. [7]. GVJ konstatoi se përbërja e komisioneve të provimeve jo në çdo rast është i përbërë nga më shumë se 1 person ku në lëndë të ndryshme, është në gjykimin e titullarit nëse korrigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë.(takimi me studentë), (RVB.fq.28) Për këtë arsye GVJ sugjeron që vlerësimi me komision i detyrueshëm vetëm për praktikat profesionale, punimin e diplomës të jetë edhe për provimet e lëndëve ose moduleve të programit.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Provimet me shkrim deklarohet se zhvillohen të sekretuara megjithatë studentët theksuan se zhvillojnë provime pa sekretim apo të koduara. Instiucioni ve në dispozicion të testeve të ndërmjetme UET – LMS e cila mundëson testim, korrigjim dhe dhënie rezultatesh në kohë reale dhe në mënyrë individuale.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me	Në kontrollin e dijeve një pjesë të rëndësishme zë puna individuale e studentëve. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve

<p>komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>komente/feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimit të detyrave/projekteve të kursit, puneve të laboratorit dhe u jep këshilla/orientime atyre se si mund të përmirësojnë performancën në të ardhmen.</p> <p>Pas provimit, nëse kërkohet, me qëllim që studenti të jetë jepen sqarime në seancat sqaruese, ku ata mund të shohin në detaje korigjimin e pedagogut dhe të marrin drejtpërdrejtë komente të detajuara mbi vlerësimin e tyre</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Mjedisi ku zhvillohet testimi monitorohet nga dy ose më shumë pedagogë, të caktuar me miratim nga Departamenti, dhe që të dy apo më shumë janë përgjegjës për ecurinë e provimit. [rvb]</p> <p>Pas dhënies së tezës, në provimin me shkrim, nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë të grupit apo kursit përkatës. Anëtarët e komisionit të provimit të modulit mbikëqyrin gjatë gjithë kohës për zhvillimin korrekt të provimit, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit. Studenti nuk lejohet të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në module të ndryshme. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të stafit akademik, me përjashtim të drejtuesit të Departamentit, të drejtuesit të Fakultetit apo persona të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori për të asistuar rregullsinë e kryerjes së provimeve. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohet përdorimi i tyre për asnjë lloj qëllimi. Rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse. Studentët deklarojnë se kopjimi nuk lejohet në mënyrë kategorike dhe ndëshkohet.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Procedura e testimit, kontrollit të dijeve dhe vlerësimit është përcaktuar në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin dhjetë nota. Nota kaluese me e ulëta është nota pesë.</p> <p>Rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit pas 2 javësh dhe pas 1 jave për riprovimet.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Mbas shpalljes së rezultateve paraprake të provimit (hedhjes së tyre në sistem) studentët kanë detyrimin e leximit të notës së tyre në sistem dhe të kontestimit të mundshëm brenda periudhës së ankimit. Në të kundërt nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem. (RVB e paqartë për këtë seksion)</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Mbas kontestimit të notës nga studentët, kërkesa e tyre për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu përkatës i lëndës të cilër më pas vendosin notën përfundimtare dhe e depozitojnë në sekretarinë mësimore. (RVB e paqartë për këtë seksion)</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit përmban lëndë dhe module që mundësojnë thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Plani mësimor i këtij program studimi ka 32 lëndë, [14.2], përfshirë praktikën profesionale dhe provimin përfundimtar, ku studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të teknikave imazherike. Kjo garantohej nëpërmjet zhvillimit të lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmblylëse. [14]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Sikundër kemi evidentuar, programi përmban kredite të alokuara për lëndët sociale dhe komunikimit më shumë se sa është e nevojshme në gjykimin tonë. Për rrjedhojë kjo kurrikul garanton zhvillimin e aftësive të veçanta përveç atyre specifike për profilin, duke ofruar module sikurse janë ato në shkencat humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). Nuk janë përfshirë njohuritë informatike bazë dhe të avancuara për të cilën edhe vetë stafi akademik u shpreh se është e nevojshme të shtohet.[14, 14.4]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lëndë.	Në syllabuset e çdo lëndë studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulin përkatës. Në javën e fundit të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Njëkohësisht, merret edhe feedback nga ana e studenteve lidhur me objektivat e vendosura për këtë qëllim.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lëndë/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Në javën e fundit të semestrit studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim si edhe për peshën që do të ketë ai në notën përfundimtare. [5]
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Përgjithësisht personeli akademik ka bërë pjesë të lëndëve literaturë të përditësuar. Realizohen orë të hapura me studentë të interesuar për zhvillime të fundit në imazheri. Përsa i përket personelit të ftuar, UET vit pas viti fton pedagoge të ftuar nga universitetet dhe institucionet shëndetësore partnere në kuadër të projekteve apo konferencave të ndyshme që zhvillohen të cilët japin leksione me studentët për përmbajtjen e të cilave bihet dakort paraprakisht me departamentin. Synohet që përmbajtja e leksioneve jashtë programit

	të studimit të përfshijë të rejat më të fundit të shkencës dhe/ose teknologjisë së informacionit dhe zbatimin e saj në mjekësi.						
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale.	Për module të caktuara të kurrikulës, pas dhënies së informacionit teorik për grup kompetencash, studentët testohen t'i aplikojnë këto kompetenca në laboratorët ku zhvillohet praktika, jashtë institucionit. Sikundër kemi theksuar, në institucion infrastruktura laboratorike e dedikuar për imazherinë është e limituar.						
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Zakonisht punët laboratorit apo praktikës profesionale realizohen me grupe të vogla studentësh. Personeli akademik mbështet, orienton dhe instrukturon në realizimin e detyrës së caktuar apo aplikimit të njohurive teorike në praktikë..[59, takimi me studente]						
Kriteri 8. Personeli akademik krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Një pjesë e personelit akademik është realtivisht i ri dhe njohës i mirë i teknikave dhe teknologjive të reja që aplikohen në diagnostikë. Në këtë mënyrë ata mbështesin idetë e studentëve në punimet e praktike duke i asistuar në momentet që kanë nevojë për më tepër informacion. [02]						
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	GVJ nuk identifikoi raste studentët janë mbështetur financiarisht në zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore. Kjo për faktin se programi i studimit është i nivelit bachelor por mbështetja sipas deklarimeve kryhet për studentët e nivelit master shkencor në imazheri. [42.1]						
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Institucioni dhe personeli akademik bashkëpunon me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Impakti i pandemisë Covid 19 është i madh në këtë drejtim përse i përket mobilitetit të studentëve. Ndërkohë është vërejtur një rritje e numrit të personelit akademik në vitin e fundit që ka marrë pjesë në mobilitete jashtë vendit , në kuadër të projekteve Erasmus + KA1. [34], [43.2]						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	UET disponon procedurën e nevojshme për mbrojtjen e diplomës dhe provimit përfundimtar, ku studentët pas përfundimit me sukses të ciklit të studimit ju lind e drejta për tu diplomuar. [10]. Mbrojtja e diplomës mund të kryhet përmes paraqitjes së një punimi diplome, i cili mund të jetë me temë diplome, për programet Bachelor, me kërkesë të studentit, për studentët me notë mesatare së paku 8.5.

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Departamenti në fillim të semestrit të parë të vitit të trete përcakton listën e temave të diplomave për studentët dhe ju ve atyre në dispozicion informacionet e nevojshme në lidhje me këto tema, gjithashtu Dekani i Fakultetit miraton listën e personelit akademik që do të udhëheqin studentët gjatë hartimit të temave të diplomave. [10]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, studentët pas përfundimit me suksese të 3 viteve të studimit kanë të drejtë të japin provimin e diplomës i cili I teston ata për të gjitha modulet që kanë zhvilluar gjatë 3 viteve. Me kërkesë të studentit, për studentët me notë mesatare së paku 8.5 mbrojtja mund të bëhet me tëmë diplome. Provimit përfundimtar bazohet në disiplinat kryesore të programit të studimit të ciklit të parë: 20% lëndë nga Kategoria A, 70% lëndë nga Kategoria B, dhe 10% lëndë nga Kategoria C. Nga viti akademik 2019-2020 pesha është 80% lëndë të kategorisë B dhe 20% lëndë të kategorisë C.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Departamenti i imazherisë në fund të vitit të trete orienton studentët duke bërë të ditur listën e pyetjeve për provimin përfundimtar e cila miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Gjithashtu në semestrin e dytë të vitit të tretë në orën e fundit të secilës lëndë, pedagogët bëjnë një përmbledhje të saj dhe i orientojnë studentët rreth temave që mund të pyetën në provimin final. [7.3]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Udhëzimet dhe asistencën e nevojshme për punimin e diplomës jepen nga Pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike ku studenti merr trajnimin e duhur për aspekteve metodologjike, përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore, punën në klinika, shkrimin, dhe nxjerrjen e rezultateve. Në institucion infrastrukturën për të asistuar studentët në kryerjen e temave të diplomave, është e limituar përveç simulimit virtual 3D. [42.1]</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Është përgjegjësi e udhëheqësit të diplomës e gjithë puna e kryer nga studenti, të dhënat e përdorura, analiza e kryer dhe cilësia e punimit. Ai garanton rezultatet dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. UET ka dhe udhëzues për hartimin dhe formatin që ndiqet nga studentët për zhvillimin dhe mbrojtjen e diplomës. [10]</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sic përcaktohet në rregulloren e programit të studimit Bsc në Imazheri, studentët pas përfundimit të provimit vlerësohen me notë ku nota 5 është kaluese dhe nota 10 vlerësimi maksimal. Në suplementin e diplomës shënohen dhe kreditet respektive të diplomës</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me</p>	<p>Në rregulloren e përgjithshme dhe atë të programit të studimit përcaktohet qartë se Studentët, që kanë përfunduar të gjitha</p>

diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	detyrimet e një programi studimi, pajisen me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj, e cila është dokument zyrtar. Ky është brezi i parë i studentëve që diplomohen në këtë program studimi			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Diploma plotësohet me të dhënat e sakta të studentit sipas formatit të miratuar nga MAS. Ajo nënshkruhet nga dekani i fakultetit dhe Rektori i UET. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e institucionit. Respektivisht sipas formës së studimit lëshohen diplomatat e ciklit të parë.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Sekretaria mësimore mban regjistrat bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, regjistrin me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave apo certifikata të dhëna mbi diplomën ose diplomatat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas akteve nënligjore në fuqi. Nga vizita në sekretarinë mësimore, u konstatua se sekretaria mësimore arkivon edhe dokumentacionin e plotë të studentëve të diplomuar sic janë listat e notave, dokumentacionin e aplikimit etj. Regjistrat e studentëve plotësohen në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahen në ruajtje të përhershme. Çdo student, me regjistrimin fillestar në UET, pajiset me numër unik matrikullimi që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës. Paralelisht, të dhënat ruhen në formatin elektronik në sistemin e brendshëm që institucioni disponon			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>UET siguron menaxhimin të burimeve njerëzore të institucionit. Për këtë qëllim zyra e Burimeve Njerëzore është një strukturë administrative koordinuese brenda institucionit e cila përditëson, menaxhon, ruan të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e UET Rregulloren e arkivimit të dokumentacionit [5]. Zyra ndjek përmbushjen e detyrimeve kontraktore të punëmarrësve në përputhje edhe me kodin e etikës, mbledh dhe harton raporte statistikore për personelin sipas kërkesave të Institucionit apo institucioneve të tjera bashkëpunuese. [34]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UET është institucion me strukturë të konsoliduar dhe efektive në funksionim dhe administrim. Çdo njësi përbërëse ka personelin respektiv [02] akademik, administrativ e mbështetës i cili është objekt i ndryshimeve dhe të vazhdueshm. Personeli i punësuar në secilën nga njësitë (kryesore, bazë, administrative dhe mbështetëse) i është nënshtruar procesit të rekrutimit në përputhje me kriteret e përcaktuara në Statutin e institucionit, rregulloren e përgjithshme dhe rregulloret përkatëse [11]</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore mban dosjet e personelit, evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Për rekrutimi i stafit të ri akademik, institucioni bazohet në respektim të kërkesave të bazës ligjore për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Kodin e Punës si dhe në Statutin e UET. Çdo vit akademik, institucioni në funksion të nevojave për personel akademik që propozon çdo njësi bazë e tij, organizon procedura konkurrimi si për personel me kohë të plotë ashtu edhe për pedagogë me kohë të pjesshme, e rregulluar kjo procedurë shprehimisht në Rregulloren e Përgjithshme të institucionit dhe akte të tjera të brendshme e [5] Zyra e financës dhe shërbimeve mbështetëse, publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit në faqen e internetit, mjetet e tjera të informimit publik, rrejte sociale, gazetën Liberale etj.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të</p>	<p>GVJ evidentoi se në përgjithësi institucioni ndjek procedurë të plotë vlerësimi të kandidatëve që aplikojnë për një pozicion të shpalluar. Megjithatë, në takimin me drejtuesit u evidentua fakti se hasen</p>

<p>shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>vështirësi në gjetjen e personelit të kualifikuar në fushën e imazherisë ose interesi i mjekësve imazheristë për tu fokusuar në mësimdhënie është i ulët. Për këtë arsye në shumë raste procedura e punësimit mund të rishpallet disa herë deri në rekrutimin e personelit të nevojshëm.</p> <p>Në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura gjithnjë është synuar përzgjedhja e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit por siç u përmend, për shkak të vështirësive, jo në çdo rast është arritur në rekrutimin e personelit të kategorisë profesor. [11]</p> <p>GVJ inkurajon institucionin të përfshijë në programin e studimit personeli me tituj e grada shkencore, të gjejë rrugë dhe mekanizma alternativë për të bërë pjesë, staf akademik qoftë nga partnerët e bashkëpunorët apo edhe të ftuar në mënyrë që lëndët apo modulet e programit që lidhen me imazherinë dhe profesionin të mbulohe nga titullarë të së njëjtës fushë. [11.1]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>GVJ identifikoi se institucioni është angazhuar për krijimin e një mjedisi komod pune dhe veprimtarie duke garantuar njëkohësisht mundësi të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale si dhe angazhime të tjera akademike apo personale. Bazuar në rregulloren e institucionit, përgjegjësi i departamentit, është autoriteti drejtues akademik i departamentit dhe e përfaqëson atë. Stafii mësimdhënës ka kushte të përshtatshme, funksionale për kryerjen e veprimtarisë së vet. Sallat / zyrat janë të pajisuara me mjetet e domosdoshme të pajisura me kompjutera, internet free, printer, skaner etj. [42.1]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ofron politika integruese të personelit akademik duke i dhënë atyre mundësinë për trajnime të ndryshme në fushën e mësimdhënies veçanërisht për atë online nëpërmjet platformave të ndryshme të cilat u përdorën gjatë pandemisë Covid 19. UET integron stafin në jetën e tij sociale duke organizuar evente të ndryshme si: promovimi i librave; organizimi i tryezave të debatit me aktorë të ndryshëm të biznesit, për çështje të ditës; pjesëmarrja e personaliteteve të ndryshme nga fusha të caktuara të shkencës, festa të ndryshme etj. [46.4] Kjo formë bashkëpunimi dhe veprimi ka krijuar frymë pozitive dhe ambient komod pune. Strategjia e zhvillimit të UET, ndër prioritetet kryesore ka kualifikimin e mëtejshëm të stafit të saj akademik.</p>

	Edhe pse nuk ofron cikë të tretë studimi në fushën e imazherisë, UET në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të tjera jashtë vendit (kryesisht Europë), bën të mundur që pedagogët të zhvillojnë disa orë mësimi, në auditoret e këtyre universiteteve (Shkëmbimet Erasmus +). Gjithashtu asiston stafin të botojnë në revista shkencore të indeksuara ose u akordohet një fond për kërkimin. Megjithatë GVJ nuk evidentoi produkt real të matshëm që vjen si rezultat i mbështetjes institucionale qoftë në aktivitetin shkencor, kualifikimin e stafit apo në zhvillimin e mëtejshëm profesional të tij.								
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Disa nga format e trajnimit të stafit në kuadër të përmirësimit të metodave të mësimdhënies veçanërisht gjatë pandemisë janë: trajnime për doktorantë, trajnime për kërkuesit e rinj, trajnime për kërkuesit, trajnime metodologjike. Gjithashtu, kryhen trajnime për përdorimin e sistemit LMS, për pedagogët, në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies në UET dhe menaxhimit më efektiv të tij. [46.4]								
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Menaxhimi i burimeve njerëzore në kuadër të programit të studimit është përgjegjësi e departamentit të imazherisë. Njëkohësisht edhe veprimtaritë që zhvillohen në nga departamenti janë në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave që ka programi i studimit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UET siguron mjedise të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore. Sikundër kemi evidentuar, infrastruktura fizike përbëhet nga sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 7,545 m ² , ku gjithsej janë 15 salla me sipërfaqe totale 1447 m ² dhe 1138 vende. Salla seminari janë gjithsej 13, me sipërfaqe 561 m ² , dhe 353 vende. Ndërkohë ka sallë konferencash, bibliotekë dhe sallë informatike dhe hapësira të përbashkëta. Meqënëse nuk kemi të dhëna për numrion total të studentëve në raport me programet e studimit dhe mjediset ku ato zhvillojnë veprimtarinë mësimore, morëm mendimin e studentëve të cilët u shprehën se infrastruktura në funksion të

	<p>leksioneve dhe seminareve është e mjaftueshme dhe se nuk kanë patur probleme me zhvillimin e tyre. [42.1], [59]</p> <p>Por GVJ gjykon se janë të limituara kapacitetet laboratorike që institucioni ofron për zhvillimin e laboratorëve qoftë të lëndëve paraklinike por edhe epër lëndë të formimit bazë e profesional.</p>		
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin mbështetës dhe gjatë vizitës në institucion rezulton se UET ka në përdorim 7 laboratorë mësimorë informatike, 1 sallë interneti. Laboratorët e informatikës/statistikës deklarohen se janë pajisur me softëaret për imazherinë por që nuk u identifikuan gjatë vizitës në sallat e laboratorëve.</p> <p>Laboratoi krijimi i laboratorit të simulimit virtual, VR, është mjaft mjaft i rëndësishëm për studentët e imazherisë për simulimin e anatomisë dhe veçanërisht anatomisë radiologjike.</p>		
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>E gjithë hapësira ku zhvillohet mësimi ka qasje në internet. Në të ardhmen institucioni duhet të fokusohet në zhvillimin e infrastrukturës laboratorike, dhe mjedise të tjera, sipas natyrës së programit me aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave dhe objektivave formues të programit të studimit..</p> <p>GVJ sugjeron që institucioni së pari të orientohet në përmirësimin e infrastrukturës që mundëson përdorimin e teknologjisë në imazheri e diagnostikë e mandej zgjerim në infrastrukturën laboratorike, teknologjinë e pajisjeve mjekësore dhe radiombrojtje [42.1]</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>UET ka disa laboratorë të teknologjisë së informacionit të cilët u shërbejnë edhe studentëve të imazherisë sikundër është p.sh laboratorit si simulimit virtual [42.1]</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Nevojat kryesore që ka programi përsa i përket praktikës laboratorike, profesionale zhvillohet në institucionet partnere. Mjediset e klinikave, qëndrave spitalore, u mundësojnë studentëve realizimin e praktikave profesionale.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushje t pjesërisht</p>	<p>Përmbushje t kryesisht</p>	<p>Përmbushje t plotësisht</p>
		X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UET ve në dispozicion të studentëve të saj mjediset e Bibliotekës me sipërfaqe rreth 35 m ² e cila është e disponueshme për studentët në orarin 08-16:00. Ndërsa në periudhë provimesh, biblioteka funksionon me orar të zgjatur. [45.1]
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka është e pajisur me tekste mësimore, literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja të revistave shkencore. Literatura fizike në bibliotekë, e cila pasurohet çdo vit. Stafi akademik parashton kërkesën për blerjen e literaturës. Në bibliotekë mundësohet akses në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia. Materialeve të vëna në dispozicion të studentëve nga titullarët nëpërmjet sistemit UET LMS janë kryesisht përmbledhje të literaturës. Sikundër kemi përmendur, GVJ ka indentifikuar numër të ulët të botimeve në fushën e imazherisë në gjuhën shqipe. Literatura në gjuhën angleze është mjaft cilësore dhe institucioni ka siguruar akses dhe të drejta në përdorimin e saj, vë vijim stafi duhet të fokusohet në përgatitjen e botimeve të plota në shqip në mënyrë që studentët të kenë materiale të mjaftueshme për tu thelluar në studimet e tyre. [45]
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Disa nga libraritë online ku studentët dhe stafi kanë akses janë Sage, Ebsco dhe Questia.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS. Biblioteka është kataloguar dhe e pajisur me sistem që mundëson shfrytëzimin e literaturës që gjendet në të.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Pasurimi i fondit të bibliotekës është një proces i vazhdueshëm ku përgjegjësi harton listën e nevojave që ka programi. Është siguruar literatura në gjuhën angleze. Sikundër thekson edhe vetë institucioni, literatura në dispozicion, duhet të pasurohet me botime më bashkëkohore në fushën e programit të studimit, kryesisht në gjuhën shqipe, por edhe në literaturë e rekomanduar në gjuhë të huaj [45][45.2]
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit	Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hëne-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00-17:00. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjatur.

mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UET ka një sistem të centralizuar të menaxhimit të institucionit fokusuar kryesisht në menaxhimin e sekretarisë mësimore. UMIS kryen edhe disa funksionalitete të tjera si ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore, menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, financat studentore, bibliotekën, etj. Ndërkohë për administrimin e veprimtarive mësimore institucioni përdor UET-LMS, një version i Moodle i përshtatur nga institucioni. [46]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UET ka nivel të kënaqshëm të përdorimit të sistemeve të informacionit dhe komunikimit megjithatë GVJ gjykon se është e nevojshme integrimi i sistemeve në një platformë të centralizuar e cila mundëson integrim të të gjitha veprimtarive dhe informacioneve dhe njëkohësisht monitorim e raportim në kohë reale për çdo veprimtari që zhvillohet. Aktiviteti akademik i institucionit administrohet nëpërmjet UET LMS. [46] Platforma përdoret prej disa vitesh duke krijuar në këtë mënyrë një bazë të mirë të dhënash që lidhen me materialet didaktike, bankën e pyetjeve, testet dhe udhëzues të ndryshëm.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UET LMS ofron informacionin bazë për studentët në lëndët e tyre përkatëse dhe kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin çdo pedagog menaxhon menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse; UET -LMS është platforma kryesore për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. [46] [46.1]

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sikundër theksuam më lart, UET nuk ka një sistem të centralizuar por platforma të ndryshme për veprimtari të caktuara. P.sh funksioni kryesor i UET LMS është të menaxhimi i veprimtarive të mësimdhënies dhe mjeti kryesor i komunikimit dhe ndërveprimit midis studentëve dhe pedagogëve.</p> <p>Kjo formë komunikimi dhe ndërveprimi, ofron më shumë mundësi interaktiviteti student pedagog dhe hapësira diskutimi të personalizuara sipas interesave të studentit</p> <p>Për të promovuar aktivitetin akademik dhe social, UET përdor gjërësisht rrjetet sociale, facebook, instagram, grupe në platforma whatsapp dhe viber etj, mjaft të përdorura nga studentët. Ndërkohë, përveç faqes zyrtare që shërben për të dhënë informacion të plotë rreth procedurave të pranimit dhe regjistrimit në institucion, kostove të edukimit, organizimit dhe menaxhimit të institucionit</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemet që UET oërdor mundësojnë marrjen ose gjenerimin e disa informacioneve në kohë reale për procese që institucioni zhvillon. Ecuria akademike, zhvillimi i procesit mësimor, rezultatet e studentëve dhe veprimtari të tjera që lidhen me procesin mësimor, janë lehtësisht të monitorueshme nëpërmjet UET-LMS ku përgjegjës është KSBC.</p> <p>Megjithatë GVJ nuk identifikoi vlerësime dhe analiza të detajuara që lidhen me performancën individuale të personelit akademik, performancën e departamentit dhe strukturave të tjera përgjegjëse për programin e studimit.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare e UET është në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Në të mund të gjenden informacione për institucionin, programet e studimit, syllabuest, personelin akademik dhe joakademik, aktivitete dhe njoftime të ndryshme.</p> <p>www.uet.edu.al</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për</p>	<p>Krijimi dhe përdorimi i burimeve financiare në UET bëhet në bazë të një plan veprimi të hartuar në fillim të çdo viti akademik. [3,4] hartimi i buxhetit dhe shpërndarja e fondeve bëhet bazuar në nevojat dhe prioritetet. Njëkohësisht për çdo muaj raportohet për realizimin e buxhetit të parashikuar nga Zyra e financës</p>

<p>mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Insitucioni nuk ka një ndarje të buxhetetve në nivel programi. I gjithë bilanci financiar, kostot, të ardhurat e generuara, janë pjesë integrale e veprimtarisë financiare të UET. [50.3]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Sikundër përmendëm, plani i financimit është pjesë integrale e menaxhimit financiar të institucionit. Nevojat për programin e studimit kërkohen nga përgjegjësi i departamentit duke filluar nga nevoja për personel akademik, infrastrukturë laboratorike, logjistikë, lietaturë, mbulim shpenzimesh për zhvillim veprimtarish akademike apo pjesmarrje në to brenda dhe jashtë vendit etj. Në dokumentin përmbledhës, [tabelat përmbledhëse 02], jepen informacione mbi kostot për program studimi në disa vite akademike. Vlerësohet pozitive ulja e kostove në vitin e fundit çka mundëson menaxhim financiar më të mirë të institucionit dhe qëndrueshmëri afatgjatë të tij.[50.1, 50.2, 50.3]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Veprimtaria financiare e UET është objekt i auditeve ligjore të pasqyrave financiare, në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe kërkesave ndërkombëtare të auditimit të raportimit financiar. Prej miratimit të Statutit të ri sipas Ligjit 80/15, i gjithë procesi financiar dhe administrimi bëhet bazuar në këtë bazë ligjore përveç atyre të cituara më lart. [1] Çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Auditimin financiar e kryen auditi i shoqërisë dhe pasqyrat financiare të institucionit bëhen publike çdo vit, së bashku me raportin përfundimtar. Institucioni ka marrë konsulencë financiare nga shoqëria “Deloitte Albania”. [50.6]</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, UET dokumenton raportet financiare dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Financimi i programit të studimit realizohet kryesisht nga tarifatat e studentëve. Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot, plani për mbështetje financiare për një cikël të plotë studimi; tarifa e shkollimit; ndarja e burimeve financiare i bashkëngjiten raportit. [50.1-6]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të</p>	<p>Burimet financiare të institucionit janë hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe shkencore të UET, duke ndjekur një politikë transparente të shpërndarjes së tyre. [43]</p>

mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Bazuar në deklaratimet e institucionit, situata financiare e UET është e qëndrueshme dhe bazuar në ecurinë e tre viteve të fundit. Konsolidimi financiar është prioritet në planin afatshkurtër të zhvillimit, çka i ka mundësuar institucionit të kryejë disa investime infrastrukturore që lidhen me transferimin e tij në mjedise të reja gjatë vitit akademik 2021-2022. UET zbaton rregullat e Ligjit për kontabilitetin, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në zbatim të tij dhe të gjitha rregullave të tjera financiare-fiskale, sipas ligjeve dhe akteve të tjera, ligjore e nënligjore			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka hartuar dhe vënë në zbatim politika dhe procedura për studentët në ciklin e parë bachelor. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në Guidën e UET. Institucioni ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë studimeve të tij. Dokumenton dhe ve në dispozicion të tij, informacione që lidhen me ecurinë e tij akademike. Në regjistrimin e studentëve në UET ndiqen Vendime të Këshillit të Ministrave apo udhëzime të MAS për kufizime në përmbushje të kërkesave të pranimit apo në kuota regjistrimi. [27.1]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Pranimi i kandidatëve bëhet në mbështetje të kapaciteteve dhe kuotave të miratuara dhe të pranuar. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e saj. [5] Rregullorja e FSHMT dhe e programit të studimit, përmban procedurat e ndjekjes së studentëve që nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve, apo transferimit të tyre.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret e pranimit dhe përparimit të studimeve të studentëve, janë publike dhe miratohen në avancë. Transferimi nga një program studimi tjetër, njohja së studimeve të kryera në një program tjetër i plotë ose i pjesshëm apo edhe i realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit Erasmus apo programe të tjera shkëmbimi studimesh përcaktohen qartë në rregulloren e fakultetit. Ky informacion është i aksesueshëm për publikun përmes faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale të UET
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Në rregulloren e programit përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit dhe përzgjedhjes për çdo vit akademik; çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore apo shtetas të huaj të cilët kanë kaluar me sukses provimin e njohjes së gjuhës shqipe dhe konvertuar diplomën e shkollës së mësme, ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në Ciklin e Parë të studimeve.
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret	Në pranimin dhe regjistrimin e studentëve, përveç kriterëve të institucionit, ndiqen Vendime të Këshillit të Ministrave apo udhëzime të MAS për kufizime në përmbushje të kërkesave të pranimit apo në kuota regjistrimi, Pranimi i kandidatëve bëhet në mbështetje të kapaciteteve dhe kuotave të miratuara dhe të pranuar. [27.1]. Janë

parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	parashikuar edhe studentë të huaj për të ndjekur programin por ende nuk ka të regjistruar nga jashtë vendit.			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UET realizon komunikimin me publikun e interesuar për ndjekjen e programit bachelor përmes disa mënyrave si gjimnaz tour, këshillimi në UET gjatë periudhës së regjistrimeve, etj. Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet java e orientimit ku realizohen takime leksione, për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të UET. Kriteret e programeve të studimit publikohen dhe i vihen në dispozicion palëve të interesuar nëpërmjet rrugëve dhe instrumenteve të ndryshme [www.uet.edu.al]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rregullorja e programit të studimit Bsc në Imazheri përmban informacione në lidhje me përparimin akademik të karrierës së studentit përmes sekretarisë mësimore dhe zyrës së mbështetjes ndaj studentëve. Këto zyra i krijojnë mundësi studentit të kontrollojë vlerësimin por edhe të marrë shërbime të tjera si: regjistrimin në një provimi, listën e notave, vërtetime etj. Në rregullore përcaktohen qartë kushtet që duhet të plotësojnë studentët për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin. [7]
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Rregullorja e Fakultetit, rregullorja e programit të studimit si dhe syllabusi i lëndës përcakton procedurat, kriteret dhe kushtet që duhen plotësuar për ekuivalentimin/njohjen e njohurive të mëparshme nga programe të ngjashme ose të përafërta.[5], [7].
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Çdo pedagog në fillim të cdo semestri i prezanton studentët me syllabusin e lëndës ku studenti mund të informohet rreth formës dhe mënyrës së vlerësimit për lëndën, për vlerësimin e dijeve ku përfshihen sistemi i vlerësimit, format e vlerësimit, për hyrjen në provime, organizimin e provimeve, ankimmimet etj. Informacionet jepen edhe në UMS dhe LMS. Studentët e interesuar mund të tërheqin pranë koordinatores së Departamentit formularin e para diplomimit, në të cilën gjenden të gjithë lëndët dhe rezultatet respektive, sikurse dhe statusi për çdo lëndë.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe	Informimi i studentëve për kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës është parashikuar në rregulloren programit. Studentët mund të zgjedhin provimin të përfundimtar ose temë diplome. Detajet jepen në dokumentin për punimin e diplomës që nga momenti i aplikimit, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës, procesin e shkrimit të

diploimit në programin e studimit.	tezës, kalendarin e seancave etj. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. [29], [10]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Sipas planit të veprimit të zyrës së mbështetjes ndaj studentëve, synimi i informimit është t'i ofrojë nxënësve objektiva dhe të dhëna faktike për UET dhe programin e studimit në veçanti. Procesi inicohet aktualisht nga MAS (në vitet e mëparshme ka qenë iniciativë e vetë institucionit) ku përcaktohen: [12], [51] <ul style="list-style-type: none"> - periudha e informimit - përfaqësuesit IAL-së - Bashkëpunimi me institucionet e arsimit para universitar me qëllim përputhjen e periudhës së vizitës. <p>UET organizon grupe pune të përbëra nga pedagogë dhe studentë, të cilët vizitojnë shkolla të mesme në qytete të ndryshme të vendit për t'iu bërë të njohur maturantëve programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët. Institucioni zhvillon ditë të hapura ku maturantët mund të vizitojnë nga afër institucionin e të ndjekin edhe orë të caktuara mësimi, si edhe javën e orientimit për studentët e rinj.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Java e orientimit të studentëve të vitit të parë konsiston në prezantimin e tyre me ambientet e institucionit (sallat e mësimi, sekretarinë, bibliotekën, sallën e informatikës, etj.). [42.1]. Gjithashtu prezantohen pedagogët dhe lëndët që do të zhvillojnë në vitin e parë, me syllabuset e secilit modul/lende. Studentët sqarohen lidhur me sezonet e provimeve, mënyrën e vlerësimit, të drejtat dhe detyrat e tyre. Ata pajisen secili me informacionet e duhura, broshura etj. [27,1]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Informacioni kryesor jepet në përmbajtje të programit të studimit. Departamenti vë në dispozicion të studentëve të përmbajtjen dhe informacione shtesë për dhe veprimtaritë formuese. Gjithashtu, informacione gjenden edhe në faqen e internetit të UET. [46.3], [46.4]. Nga personeli vihen në dispozicion informacion rreth përmbajtjes së moduleve si, ngarkesa, temat për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës etj.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe	Ditët e Informimit përfshijnë edhe aktivitete të tjera si realizimin e takimeve midis klinikave të ndryshme, agjencive të punësimit të

mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	punësimit jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë. Informimi i studentëve në raport me vendet vakante për profesionet e tyre jashtë vendit dhe kriteret që ato kanë, këto kompani mund ti paraqesin edhe në mjediset e akademisë. [59] Studentët deklarojnë se ata kanë siguruar kontakte dhe informacione gjatë fazës së zhvillimit të praktikave profesionale.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Sikundër kemi përmendur më lart, sapo një maturant merr statusin e studentit, ai ka akses ne UET-LMS nga ku mund të informohet për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. [27.2]. Tutori i programit ka kontakt të përhershëm me studentët dhe i asiston ata në nevojën që mund të kenë për informacione të ndryshme. [27]			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Informacioni mbi programin, përmbajtjen etj, jepet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit UET – LMS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe zyrës së mbështetjes ndaj studnetëve, KSBC, sistemeve të menaxhimit, UET , disponon të dhëna mbi ecurinë e studentëve të programit të studimit Bsc në Imazheri, që nga momenti i regjistrimit deri në diplomon , si dhe të dhëna që kanë të bëjnë me numrin e studentëve që vazhdojnë studimet aktualisht në programin e studimit, numrin e të diplomuarve etj. [9], [59]
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me	Në regjistrin elektronik dhe hard copy që mban sekretaria mësimore pasqyrohet ecuria akademike vjetore e studentëve, duke përfshire vlerësimin, frekuentimin etj. [9] Për çdo student mbahen rekordet në lidhje me tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, ndërprerja e përkohshme, etj.

sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.							
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	UET disponon të dhëna për ecurinë e studentëve. Në sekretarinë mësimore, çdo student ka dosjen e tij me të dhëna nga regjistrimi deri tek diplomimi. Pas diplomimit, institucioni ruan kopje të dokumenteve për një kohë të pacaktuar si diploma, notat etj.						
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Përpunimi i të dhënave personale të studentëve kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e UET. [5] Informacionet administrohen nga UMIS nëpërmjet Zyrës së IT ku një person përgjegjës ka rol kryesor në menaxhimin teknik të sistemit UMIS.						
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti mundëson raportin vjetor të analizës së veprimtarive akademike. Ky raport analizon gjendjen e programit duke iu përgjigjur disa prej problematikave që mund të jenë shfaqur dhe propozon ndryshimet e mundshme që mund të përmirësojnë situatën. [43] Ndërkohë deklarohet se përpara përfundimit të semestrit studentët bëjnë vlerësimin anonim të pedagogëve me të cilët kanë zhvilluar mësim. Ky vlerësim bëhet elektronikisht, nëpërmjet sistemit LMS, me një sërë pyetjesh mbi cilësinë e zhvillimit të mësimit nga pedagogu, apo cilësinë e literaturës ku bazohet lënda, gatishmërinë e pedagogut për të ndihmuar studentët në përmbushjen e detyrimeve të lëndës, apo për t'i sqaruar në lidhje me rezultatet e vlerësimit të përvetësimit të dijeve. Raporte të vlerësimeve nuk janë bërë pjesë e dosjes së vlerësimit. Programi është në fazën e parë të tij dhe sikundër u theksua, pas diplomimit të parë të studentëve do të kryejt një analizë e plotë për përmbajtjen dhe zhvillimin e tij në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të tij						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të	UET u ka dhënë hapësirën e duhur studentëve për të qënë pjesë integrale e institucionit. Në statut, rregullore dhe në çdo akt tjetër të institucionit, studentët janë pjesë e diskutimeve dhe vendimarrjes. Studentët janë të organizuar zyrtarisht në organin përfaqësues të

<p>tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Këshillit Studentor bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë, përfaqësohen në Senatin Akademik, Këshillin e etikës, KSBC etj</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Këshilli Studentor i është një organizëm i pavarur i studentëve i cili promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UET, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve. UET inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre, parashikuar kjo shprehimisht në dispozitat e Statuti të UET [1]</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Studentët deklaruan se merret mendimi i tyre në përmirësimin e programit të studimit. Ata pyeten nga pedagogët për temat ose orët në dispozicion. Nga ana tjetër, Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucionit, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. [59]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojnë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Bazuar në deklaratimet e drejtuesit të departamentit dhe personelit akademik, pas përfundimit të këtij procesi, programi do të nënshtrohet një analize gjithëpërfshirëse, rishikimi dhe përmirësimi. Pjesë e grupit të punës do të jenë dhe studentët aktuale ose të diplomuar.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në rregulloren e programit dhe të KSBC, janë përcaktuar praktikatat ku studentët mund të vlerësojnë kryerjen e procesit të vlerësimit apo mësimdhënies me anë të anketimeve anonime që kryejnë dy herë në vit. Gjithashtu në këto rregullore përcaktohet e drejta e studentëve për të ankimuar vlerësimin e kryer nga pedagogu dhe rishikimin dhe reflektimin e notës nga ana e pedagogut në rastet kur studenti e meriton. Për programin deklarohet se merret mendimi i studentëve për tematika të caktuara si procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, mundësia e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës, etj. Janë paraqitur formularët me të cilët merret mendimi i tyre por nuk janë dhënë raporte analitike të vlerësimit apo rekomandimeve për përmirësim.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	UET ka strukturë të posaçme që siguron këshillimin e studentëve, orientimin e tyre si dhe komunikimin me personelin akademik [12]. Zyra e shërbimit ndaj studentëve e cila siguron dhe mbështet orientimin dhe komunikimin e studentëve për programin e studimit dhe është përgjegjëse për ecurinë e tyre në institucion [29] Institucioni ofron lehtësira të komunikimit të brendshëm të personelit akademik dhe studentëve të tij.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Realizimi i tutoriatit kryhet në nivel njësie bazë dhe mundëson komunikimin e drejtpërdrejtë të studentit me pedagogët e tij. Departamenti kryen mbledhje të hapura me pedagogë e studentë për të kontrolluar mbarëvajtjen e studimeve dhe për të shprehur të gjithë mendimet apo problematikat nga studentët. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Për sa i përket komunikimit të jashtëm, institucioni ofron mundësitë e komunikimit dhe ndërveprimit nëpërmjet UET LMS, rrjeteve sociale, adresat e-mailit, posterat e afishuara në këndet e informimit etj.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në bashkëpunim me Zyrën e karrirës organizon aktivitetet për njohjen e studentëve me institucionin, pedagogët, mjediset, rregulloret, të drejtat dhe detyrimet e studentit [12] Zyra e Karrierës ofron informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit. Nga ana tjetër, departamenti ka caktuar një pedagog në rolin e këshilluesit të karrierës. GVJ identifikoi si praktikë të mirë ndërveprimin e studentëve me departamentin, stafin dhe zyrat mbështetëse ndaj studentëve lidhur me informimin dhe dhënien e informacioneve për punësim. Rezultate do të shihen në punësimin e studentëve që do të diplomohen nëse ato kanë qenë ose jo rezultative.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të	Institucioni vë në dispozicion të studentëve materiale edhe broshura informuese për t'i orientuar ata drejt tregut të punës dhe punësimit. Paralelisht asistohen për. përgatitjen e rezumeve, formateve të CV-ve, letrave të shprehjes së interesit për punë, dhe aftësive të tyre për të fituar intervistat, në zbatimin e vendimeve që marrin dhe duke i

programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	mësuar se si të kryejnë një kërkim për punë apo të planifikojnë një kualifikim tjetër profesional. Në UET funksionon prej vitesh Zyra alumni e cila përveç regjistrimit të studentëve të diplomuar do të ndjekë ata pas përfundimit të studimeve [12], [29]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sipas nenit. 103 të Ligjit të Arsimit të Lartë, pika 1, citohet: “Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.” [1] UET funksionon në përputhje të plotë me kërkesat ligjore duke patur funksionale Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, harton procedura dhe politika për përmirësimin e vazhdueshëm të saj. [30.2]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive akademike që zhvillon UET-it. Ai ka akses të plotë në të gjitha të dhënat e institucionit. Pjesë e analizës së institucionit është vetëvlerësimi për evidentimin e problematikave dhe adresimi për zgjidhjen e tyre si një proces i përmirësimit të vazhdueshëm të institucionit. [30.2]. Gjithashtu pjesë e sistemit të sigurimit të cilësisë është edhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, roli së cilës është zhvillimi i politikave në funksion të rritjes së cilësisë në UET. Institucioni deklaron se përfshin në procese të ndryshme edhe ekspertë ose institucione të jashtëm. Shembull i këtij koncepti është edhe akreditimi aktual që është duke u zhvilluar me QAA.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	UET ka të konsoliduar sistemin e sigurimit të cilësisë pasi ka zhvilluar një numër të madh procesesh të vlerësimit në kuadër të akreditimit të programeve dhe institucionit me ASCAL. Këto procese kanë ndihmuar në përmirësimin dhe fuqizimin e strukturave të brendshme të institucionit. Përfshirja e institucionit në projekte të cilësisë sikundër është QainAL i ka dhënë dimensionin ndërkombëtar sistemit të sigurimit të cilësisë. Në vijim të këtij procesi, GVJ sugjeron rishikimin e Manualit të sigurimit të cilësisë dhe reflektimit në të Kodit të cilësisë të miratuar me VKM në vitin 2021.
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang	Në rregulloren e KSBC dhe Manualin e sigurimit të cilësisë, përcaktohen politikat dhe procedurat që ndiqen për përmirësimin e cilësisë në programet e studimit, disa nga këto procedura janë anketime me studentët, plani i aktiviteteve, formulari i personelit akademik etj. [30.8, 32.2, 32.1, 40.1, 41]. Në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen.

institucional, të njëjive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Përmirësimi i programit në përmbajtje dhe ndryshimet eventuale në të, do të kryhen pas përfundimit të fazës së parë të zbatimit të tij pas licensimit. UET ka mekanizma të konsoliduara lidhur me analizën, vlerësimin dhe rishikimin e programeve të studimit. [52]. Pas analizës paraprake, propozimet dhe përmirësimet ndërthuren me kërkesat e tregut dhe në funksion të rritjes së mëtejshme të ciclisë së studentëve që diplomohen në këtë program. Çdo vit, bazuar në planet vletore, institucioni e kryen analizën për programet e studimit që ai ofron.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Mbi bazë të analizës paraprake dhe raportit të hartuar në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programit të studimit, cilësinë, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore etj, propozohen ndryshimet eventuale. [30.5] E njëjta procedurë do të ndiqet edhe në kuadër të rishikimeve eventuale që do të bëhen në programin e studimit Bsc. në Imazheri.
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Në takimin me KSBC, u theksua se në mënyrë periodike, departamentet komunikojnë me secilin pedagog, për aspekte të mësimdhënies, vlerësimin, angazhimin në çështjet administrative të departamentit, mbi veprimtarinë kërkimore - shkencore dhe trajnimet e pedagogut .[30.8]. Në këtë drejtim, institucioni është konsoliduar pas një eksperiencë shumëvjeçare. Megjithatë, analizat, raportimet dhe feedback për këtë program, janë të pakta
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Gjetjet dhe konstatimet që dalin nga vlerësime periodike apo had-hoc, u vihen në dispozicion drejtuesëve për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e programit të studimit
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit	Rishikim i syllabuseve në % të vogël, me qëllim azhornimin e tyre në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit, kryhet në mënyrë periodike. KSBC monitoron në mënyrë

dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	të vazhdueshme mënyrën se si ofrohet programi i studimit dhe përputhshmërinë me standardet e cilësisë. [30.1] Një analizë gjithëpërfshirëse, ende nuk është kryer ku pas diplomimit, një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e syllabuseve do të japin dhe studentët e diplomuar.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Institucioni, konkretisht departamenti, kryen në mënyrë periodike monitorimin e programit në mënyrë që ai të përmbushë standartet e cilësisë. [29] Për faktin që ky është program i ofruar në këto 3 vite, ende programi nuk ka qënë pjesë e vlerësimit të brendshëm dhe analizës së institucionit për të parë se cilat janë indikatorët ku programi është në përputhje me kërkesat e tregut dhe studentët dhe në cilat drejtime ai duhet të përmirësohet.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	UET ka hartur një Manual të sigurimit të brendshëm të cilësisë i cili reflekton standartet dhe kriteret tona të sigurimit të cilësisë dhe ato të hapësisrës evropiane. Sikundër kemi përmendur më lart, ky manual është e nevojshme të përditësohet duke reflektuar ndryshimet e fundit në Kodin e Cilësisë të miratuar me VKM. [30.2]
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime	Monitorimi është proces i pandarë qoftë në zhvillimin e veprimtarive akademike si: cilësia e mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, statistika të ndryshme etj. [30.3] Megjithatë ndërkohë që mekanizmat janë, formatet për vlerësime të ndryshme ekzistojnë, ende ka shkallë të ulët të analizës dhe raportimit të gjetjeve që dalin nga vlerësime të drejtpërdrejta nga departamenti apo strukturat e tjera.

ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.									
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Në monitorimin dhe vlerësimin me metoda të tërthorta, UET aplikon disa forma; vlerësimi me sondazhe e intervista të studentëve, të personelit akademik, ndihmës-akademik etj. [40]</p> <p>Në UET-LMS aplikohen pyetësorë periodikë në çdo semestër për marrjen e mendimit të studentëve. Për këtë program nuk është kryer një analizë e plotë por nga takimi me studentët referohet se ata pyeten rregullisht për aspekte të ndryshme të procesit mësimor ose praktikës profesionale.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="587 981 821 1064">Përmbushet</td> <td data-bbox="821 981 1005 1064">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="1005 981 1189 1064">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1189 981 1370 1064">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td data-bbox="587 1064 821 1108"></td> <td data-bbox="821 1064 1005 1108"></td> <td data-bbox="1005 1064 1189 1108"></td> <td data-bbox="1189 1064 1370 1108">X</td> </tr> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UET përfshin në veprimtaritë e veta personel që ka eksperiencë të gjatë dhe ofron ekspertizë në sigurimin e cilësisë. Në institucion, pranë departamenteve dhe organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës, përfshihen gjithnjë persona që e kanë këtë eksperiencë. Po ashtu, në KSBC personat e angazhuar kanë eksperiencë të gjatë në këtë drejtim por angazhohen dhe persona të tjerë si ekspertë të jashtëm. [30]</p> <p>UET ka qënë partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë: projekti “Enchase” [30.9] dhe projekti Erasmus+ QainAL [30.10] që lidhen me shkëmbimin e përvojave, njohja me qasje të reja dhe të ndryshme, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Ndërkohë shumë prej anëtarët e personelit akademik të UET angazhohen jashtë institucionit në borde të ndryshme apo si ekspertë përfshirë dhe angazhimin pranë ASCAL në proceset e akreditimit.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në rregulloren e institucionit dhe të KSBC janë të përcaktuara qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej anëtarve të zyrës. KSBC përbëhet nga personel me eksperiencë në fushën e e sigurimit të cilësisë. [30.4]</p> <p>Në secilin funksion janë përcaktuar përgjegjësitë konkrete institucionale të cilat lehtësojnë jo vetëm aktivitetin por edhe motivojnë stafin të jetë I përgjegjshëm në funksionet që kryen</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Metodat e vlerësimit dhe të rivlerësimit të cilësisë bazohen në angazhimin dhe përgjegjësinë kryesore të departamentit. Në rastin konkret, pjesë e GVB janë anëtarë të stafit akademik që kanë njohje të mirë mbi programin e studimit.</p> <p>Mekanizmat kryesore të matjes në bazë të të cilave institucioni kryen vetëvlerësimin janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat e mbledhura nga mekanizmat e reagimit, grupet e vlerësimit; puna në ekip e orientuar drejt diskutimeve - rishikuesit vetë-rregullatorë (të jashtëm dhe të brendshëm); grupet e interesit, intervista individuale etj; • Të dhëna statistikore të disponueshme në njësitë përbërëse të akademisë, që janë treguesit kyç të performancës (të dhëna për nivelin e suksesit të studentëve, studentët që regjistrohen dhe që përfundojnë studimet brenda kohëzgjatjes normale të studimit, numri i stafit akademik, alokimet e buxhetit dhe elemente të ngjashëm); • Rezultate dhe të dhëna të tjera dokumentuese (teza provimesh dhe përgjigjet përkatëse, publikimesh, vëzhgime të procesit mësimor dhe elementë të ngjashëm), ku këto të dhëna i vihen në dispozicion titullarëve njësisë përkatëse. <p>[30.5], [30.1]</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Manuali i KSBC, garantojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi.[30.2]. Kjo vërteton se nga përfshirja dhe aktivizimi i aktoreve të brendshëm, antarët e KSBC janë antarë të stafit akademik me eksperiencë, me integritet, duke shmangur çdo lloj diskriminimi, ka përfaqësues nga i gjithë personeli akademik, administrativ dhe studentor. [30.4].</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë bëhen dhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit dhe ekspertiza e tyre ndikon në rritjen e cilësisë së programit të studimit. [59, takimi me drejtues]]</p> <p>Hartimi, miratimi dhe rishikimi i kurrikulave që ofron UET bëhet në nivel fakulteti dhe departamenti, si dhe monitorohet nga njësi përgjegjëse e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Për rishikimin e programit të studimi, përveç stafit akademik të njësisë përgjegjëse, do të ketë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekspertë të jashtëm që ofrojnë informacione dhe orientime përkatëse mbi zhvillimet aktuale të programit

	<ul style="list-style-type: none"> - Partnerë program nga institucione me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi - Studentë që studiojnë aktualisht në program - Të diplomuar nga programi - Shoqata/Urdhrat përkatës profesionale - Burime dhe ekspertë të jashtëm që ofrojnë informacion përkatës dhe orientime për tregun e punës ku gjen zbatim programi. [30.4] 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UET ka hartuar strategjinë për sigurimin e brendshëm të cilësisë [30.3] si dhe ka në përdorim Manualin e sigurimit të brendshëm të cilësisë [30.2]. Ndërkohë të gjitha aktet kryesore të institucionit si statuti, rregulloret etj, kanë në paragrafë apo nene dedikuar cilësisë. Pjesë e veprimtarisë është zhvillimi i proceseve në mënyrë transparente.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rezultatet e përfituara nga monitorimet dhe vlerësimet e bëra bëhen publike për stafin, studentët, administratën dhe më gjerë. [50.4, 50.5, 50.6, 46.5, 46.6] Edhe pse nuk ka raportime të vlerësimeve të performancës individuale të personelit akademik dhe administrativ, në takime u deklarua se rezultatet e vlerësimit nga KBSC në lidhje me pedagogët i komunikohen personalisht pedagogëve ndërkohë rezultatet e përgjithshme bëhen publike si produkte statistikore dhe renditëse por në formë anonime. KSBC informon rektoratin, drejtuesit për rezultatet që dalin nga anketimet e drejtpërdrejta me studentët ose rezultatet të kontrolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Për secilin nga proceset akademike që vlerësohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre KSBC raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Njëkohësisht, rekomandon detyra, zbatimin e cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë KSBC. Shpesh rekomandimet kanë qënë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit, në disa raste janë

	<p>shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm.</p> <p>UET mundëson zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme të fokusuara kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe kërkimin shkencor, mbështetjen e stafit akademik për pjesëmarrjen bashkëpunime ndërkombëtare në kuadër të shkëmbimit të stafit etj.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të akademisë dhe harton Raportet përkatëse të analizës së brendshme. Një pjesë e analizës paraqitet në Raportin vjetor të dërguar në MAS sipas formatit të kërkuar nga ministria [31, 31.1]. Këto raporte diskutohen në UET me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Për sigurimin e brendshëm të cilësisë institucioni fokusohet në shpërndarjen e informacionit, njohjen e rregulloreve të brendshme të institucionit.</p> <p>GVJ konstaton se UET është një institucion gjithëpërfshirës ku personeli dhe studentët integrohen dhe janë pjesë e cilësisë e cila konsiderohet e nevojshme dhe shndërrohet në kulturë institucionale. [59, takimi me stafin admin]. Në këtë kuadër, kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit e pedagogëve, të rinj, në drejtim të përgatitjes pedagogjike e psikologjike të tyre. Gjithashtu, këta pedagogë dhe ata me kontratë trajnohen në njohje të akteve rregullatore të institucionit në të gjitha nivelet (departament, fakultet, rektorat) duke vënë theksin jo vetëm në njohjen e specifikave të tyre, por edhe në aspekte metodike dhe të organizimit të mësimin.</p> <p>Ndikim të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, tërheqja e mendimit të këshillit studentor ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, apo për çdo lëndë e pedagog të veçantë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë bachelor në “Imazheri”, të institucionit të arsimit të lartë, Universiteti Europian i Tiranës

Pikat e forta dhe afirmime:

1. UET është institucion i konsoliduar që operon prej shumë vitesh në arsimin e lartë në Shqipëri
2. Angazhimin si personel akademik i teknikëve të imazherisë që kanë përfunduar të njëjtin program studimi dhe janë në ushtrimin e profesionit, ndikon në fokusimin e veprimtarive akademike në nevojat reale që ka programi
3. Bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh arsimore e shëndetësore vendase, krijon mundësi shkëmbimi në nivel institucional dhe në funksion të programit të studimit
4. Përmbajtja e programit edhe në gjuhën angleze mundëson jo vetëm lehtësime për transferimin e studentëve por ndihmon studentët në gjetjen e materialeve shtesë në internet dhe shfrytëzimin e literaturës online.
5. Studentëve u vihet në dispozicion literaturë e huaj si pjesë e literaturës bazë dhe asaj të huaj çka i ndihmon ata të përdorin botimet më të fundit në fushën e imazherisë
6. Konsolidimi i KSBCV ka ndikuar në veprimtarinë e lidhur me sigurimin e cilësisë, nxitjen e inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.
7. UET, nxit vazhdimisht kualifikimin e stafit akademik, e fokusuar në organizimin e konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, promovimin nëpërmjet mbështetjes financiare në aktivitete të ndryshme shkencore dhe trajnuese, në hartimin e teksteve të ndryshme mësimore etj.
8. Fryma pozitive dhe bashkëpunimi midis stafit akademik brenda institucionit, ndikon në nxitjen e bashkëpunimeve, rritjen e cilësisë dhe performancës e stafit në veprimtaritë akademike.
9. Përmirësimi i menaxhimit dhe administrimi të institucionit, ulja e kostove në vitin e fundit, ka mundur efikasitetin më të mirë të institucionit dhe garanton qëndrueshmëri afatgjatë të tij.
10. Ndërveprimi i studentëve me departamentin, stafin dhe zyrat mbështetëse ndaj studentëve, mbështetja dhe informimi për punësim dhe ofrimi i shërbimeve ndaj studentëve, vlerësohen pozitivisht.

Pika të dobëta:

1. Shpërndarje jo e qartë në ngarkesën mësimore ndërmjet veprimtarive formuese, praktikës profesionale veçanërisht në lëndët që aplikojnë teknologjinë në diagnostikë.
2. Personel akademik në lëndë/module të ndryshme është jo në përputhje me fushën, titujt dhe gradat shkencore që lidhen me imazherinë.
3. Departamentit i nevojitet personel akademik i fushës së imazherisë i kategorisë profesor jo vetëm për mbulimin e lëndëve profesionale por edhe për veprimtari të tjera kërkimore, udhëheqje diplomash etj.
4. Institucioni ende nuk ka infrastrukturë të mirëfilltë laboratorike për zhvillimin e laboratorëve për lëndët paraklinike, lëndët e formimit bazë e profesional.

Rekomandime:

1. Institucioni të hartojë dhe zbatojë një metodologji për shpërndarjen e ngarkesës midis veprimtarive mësimore në programe të fushave të ndryshme, veçanërisht e nevojshme për programet e skencave mjekësore.

2. Programi i studimit ka nevojë të përmirësohet duke marrë në konsideratë: orientimin në lëndët me drejtim imazherik, praktikës profesionale dhe aplikimeve të teknologjisë në diagnostikë, direktivat evropiane për profesionet e rregulluara. Përmirësimi i programit të bëhet bazuar në këtë metodologji e miratuar për të ruajtur raporte të qarta midis veprimtarive formuese.
3. Departamentit i nevojitet personel akademik i fushës së imazherisë i kategorisë profesor jo vetëm për mbulimin e lëndëve profesionale por edhe për veprimtari të tjera kërkimore, udhëheqje diplomash etj.
4. Institucioni të fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës laboratorike ose të sigurojë atë nëpërmjet marrëveshjeve të dedikuara të bashkëpunimit për zhvillimin e laboratorëve për lëndëve paraklinike, për lëndë e formimit bazë e ato profesionale.

**Conclusions of the evaluation of the first cycle bachelor's study program in "Imaging",
institution of higher education, European University of Tirana.**

Strengths and Affirmations:

1. UET is a consolidated institution that has been operating for many years in higher education in Albania.
2. The engagement as academic staff of imaging technicians who have completed the same study program and who are practicing the profession affects the focus of academic activities on the real needs of the program.
3. Cooperation with a significant number of local educational and health institutions creates opportunities for exchange at the institutional level and in function of the study program
4. Program content and in English language, facilitates the transfer of students and helps students to find additional materials on the Internet and use the online literature.
5. Literature is made available to students as part of the core and foreign literature which helps them to use the latest publications in the field of imaging.
6. The consolidation of KSBCV has influenced the priority related to quality assurance, the promotion of the encouragement of the academic staff for the further improvement of teaching.
7. UET constantly promotes the qualification of academic staff, focused on the organization of national and international scientific conferences, promotion through financial support in various scientific and training activities, in the design of various teaching texts.
8. The positive spirit and cooperation between the academic staff within the institution, affects the incentive of collaborations, increasing the quality and performance of staff in academic activities.
9. Improving the management and administration of the institution, reducing costs in the last year, has enabled better efficiency of the institution and guarantees its long-term sustainability
10. In the interaction of students with the department, staff and student support offices, my support and information for employment and the provision of services to students are positively evaluated.

Weak points:

1. Unclear distribution in the allocation of the teaching load between formative activities, professional practice and necessary subjects that apply technology in diagnostics
2. Academic staff in different subjects/modules is not in accordance with the field, titles and qualification in the field of imaging

3. Department needs academic academic staff of the professor category, in the field of imaging not only for the coverage of professional subjects but also for other research activities, management of diplomas, etc.
4. The institution still does not have real laboratory infrastructure for the development of laboratories for pre- clinical subjects, for subjects of basic and professional training.

Recommendations:

1. The institution should design and implement a methodology for distributing the credits between teaching activities in programs of different fields especially in the field of medicine.
2. The study program needs to be improved taking into consideration: the orientation in subjects with imaging direction, professional practice and technology applications in diagnostics, European directives for regulated professions in the field of medicine. The improvement of the program should be based on a methodology to maintain clear relationships between teaching and learning activities.
3. Department needs academic personnel in the field of imaging of the professor category not only to cover professional subjects but also for other research activities, diplomas theses mentoring, etc.
4. The institution should focus on improving the laboratory infrastructure or provide it through dedicated cooperation agreements for the development of laboratories for preclinical subjects, for subjects of basic and professional training.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Imazheri” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përmbushen plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Aneke

Lista e dokumenteve mbështetëse për procesin e akreditimit të programit të ciklit të parë të studimit: Bachelor në “Imazheri”

1. Mendimi i Dekanit
2. Statuti i UET
3. Plani Strategjik UET 2015-2020
 - 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020
 - 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025
 - 3.3 Plani Strategjik UET 2021
4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit
5. Rregullore e UET
 - 5.1. Vendim_Mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe Mbi lëshimin e formave te diplomave
 - 5.2. Rregullore tranzitore_Mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pademisë COVID-19
 - 5.3. Rregullore tranzitore_Per zhvillimin e procesit akademik gjate Vitit Akademik 2020-2021
6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit
7. Rregullore e programit të studimit BA Imazheri (shqip)
 - 7.1. Rregullore e programit të studimit BA Imazheri (anglisht)
 - 7.2. Sistemi i vlerësimit të studentëve
 - 7.3. Formati i tezës së provimit përfundimtar
8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë
9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore
10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit
 - 10.1. Kalendar akademik 2018-2019
 - 10.2. Kalendar akademik 2019-2020
 - 10.3. Kalendar akademik 2020-2021
 - 10.4. Kalendar akademik 2021-2022
11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore
 - 11.1. Shembull thirrje për staf akademik
12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit
 - 12.1. Bordi i Tregut të Punës FSHMT
 - 12.2. Netëork i bashkëpunëtorëve të tjerë - FSHMT
 - 12.3. Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019
 - 12.4. Realitetet e Reja të Post-Covid 19 në Tregun e Punës 2020
13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave
14. Kurrikula e programit BA Imazheri (shqip)
 - 14.1. Kurrikula e programit BA Imazheri (anglisht)
 - 14.2. Plani mësimor i programit (shqip)
 - 14.3. Plani mësimor i programit (anglisht)
 - 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Imazheri

15. Modeli i diplomës (Urdhëri i aprovimit – nuk ka, pritët akreditimi); Modeli i Suplementit të Diplomës
16. Argumentimi për hapjen e programit të studimit
17. Studimi për tregun e punës
18. Adresimi i rekomandimeve të hapjes ose akreditimeve të mëparshme
19. Syllabusët e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BA Imazheri
- 19.1. Formati i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018
20. CV e stafit akademik të programit të studimit
21. CV e stafit akademik udhëheqës i diplomavë (në rastin kur nuk është pjesë e stafit akademik të programit)
22. CV e stafit ndihmës akademik
23. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse
24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit ndër vite (Aneks Tabela 6, 12, 7, 8)
25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit (Aneks Tabela 4)
26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse
27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin
 - 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve
 - 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik
28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin
 - 28.1. Projektet UET_2014-2020
 - 28.2. <https://uet.edu.al/inter-institutional-agreement/>
 - 28.3. <https://uet.edu.al/active-projects/>
 - 28.4. <https://uet.edu.al/completed-projects/>
29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre - Imazheri
30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC
 - 30.1. Plani veprimi KSBC
 - 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë
 - 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2020
 - 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC
 - 30.5. Metodologjia e punës së KSBC_Provimet
 - 30.6. Format_Raporti për provimet
 - 30.7. Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabusët
 - 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu
 - 30.9. Fisha e projektit Enchase
 - 30.10. Fisha e projektit QainAL
 - 30.11. Fisha e projektit Bologna Hub Peer Support
31. Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80/2015), apo Udhëzimeve Kombëtare e Europiane (nuk kanë dalë ende aktet nga MASR)
32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale (Aneks Tabela 5/Dokumentimi nr.ref. 34.1)
 - 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale
 - 32.2. B-I-4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës (nga Studenti)
33. Të dhëna për trajnimet profesionale

34. Marrëveshje bashkëpunimi – lista UET
- 34.1. Marrëveshje bashkëpunimi – lista Departamenti Imazherisë
- 34.2. Memorandum bashkëpunimi_UET-Poliklinika Gjermane
- 34.3. Marrëveshje bashkëpunimi UET_QSUT
- 34.4. Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe QKU
- 34.5. Memorandum bashkëpunimi_UET-Salus
- 34.6. Memorandum bashkëpunimi_UET-Spitali i Traumës
35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit
37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve
38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional
39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës
40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët
- 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve
41. G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik
42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Blv. “Gjergj Fishta”
- 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”
43. Raporti i punës kërkimore shkencore - Departamenti Imazheri
- 43.1. Të dhëna mbi projektet dhe bashkëpunimin ndërkombëtar
- 43.2. Mobility agreement_IIA_UET_Cordoba
- 43.3. Memorandum bashkëpunimi UET_Tirol_Agreement
44. Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE):
- 44.1 Format dosje staf akademik me kohë të plotë
- 44.2 Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme
45. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit BA “Imazheri”
- 45.a Lista e teksteve elektronike
- 45.b Lista e teksteve bazë dhe të detyrueshme
- 45.1 Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës
- 45.2 E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë
- 45.3 Shembull procedure_blerje literature
46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS
- 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS
- 46.2 UET LMS Guide për pedagogun
- 46.3 UET LMS Guide për studentet
- 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS/LMS
- 46.5 Raport: ecuria e mësimin online
- 46.6 Raportimet javore të mësimin online
47. Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës [ëëë.uet.edu.al](http://uet.edu.al);
<http://uet.edu.al/neë/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-teknike>
48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online
49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1)
50. Të dhëna dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)
- 50.1. Pasqyrat Financiare 2018 me shënime
- 50.2. Pasqyrat Financiare 2019 me shënime

68

- 50.3. Pasqyrat Financiare 2020 me shënime
- 50.4. Raport auditimi viti 2018
- 50.5. Raport auditimi viti 2019
- 50.6. Raport auditimi viti 2020
- 51. Politika e marketingut të programit të studimit
- 52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës (Nuk ka – program i ri / Argumentim dokumenti Nr. 18)
- 53. Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”
- 53.1. VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar
- 53.2. VKM Nr. 531, datë 11.06.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”
- 54. UMASR Nr. 557, datë 12.09.2018 “Për hapjen e programit BA Imazheri, UET”
- 54.1. VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 “Për hapjen e UET”
- 54.2. UMASR Nr. 528, datë 04.09.2018 “Për hapjen e FSHMT në UET”
- 54.3. VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 “Për akreditimin institucional të UET”
- 54.4. VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 “Për akreditimin e UET”
- 54.5. Certifikatë Akreditimi UET
- 55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)
- 55.1. Kalendar i aktivitetëve 2018-2021
- 56. A.II. Kodi i Etikë
- 57. www.ascal.al
- 58. Sistemi i ASCAL – AMS
- 59. Takimet me drejtuesin e departamentit, personelin akademik, studentët, shërbimet mbështetëse, sekretaria, vizita në infrastrukturën e institucionit